



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 654 Akti

Nr. 736 Vendimi
Tiranë, më 31.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 30.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentjan Habazaj**, me funksion prokuror, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit

kalimtar të subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj, me funksion prokuror, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentjan Habazaj, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 15.1.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentjan Habazaj; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit, në datën 26.1.2024.

8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Gentjan Habazaj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 26.1.2024.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 30.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Gentjan Habazaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Gentjan Habazaj:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për burimin e krijimit të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Z. Gentjan Habazaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367,

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: (i) para fillimit të detyrës, të vitit 2009; (ii) periodike/vjetore për vitet 2009 – 2018; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

20. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 23.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2009 – 2018, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

21. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

Deklarimi i pasurisë² nga subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj

1. Depozitë bankare dhe gjendje kursimesh *cash*

a. *Depozitë bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 4,800,000 lekë*

b. *Gjendje kursimesh *cash* në vlerën 700,000 lekë*

Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë:

a. *Depozitë në Raiffeisen Bank nr. ***, në lekë, hapur në datën 8.2.2016. E kam pasur si depozitë në BKT para funksionit si prokuror, në vlerën 5,400,082 lekë, depozituar nga prindërit në datën 13.6.2003, nga kursimet e tyre. Vlera: 4,800,000 lekë. Zotëroj: 100%.*

b. *Gjendje *cash* në shtëpi, që më ka mbetur aktualisht nga kursimet nga paga si prokuror, diferenca e çmimit të shitjes së makinës tip “****” me targë AA *** dhe diferenca e depozitës së çelur pranë Raiffeisen Bank. Vlera: 700,000 lekë.*

² Deklarimi i pasurisë sipas deklaratës *Vetting*.

1.1 ILDKPKI-ja ka konstatuar: *Mungesë dokumentacioni justifikues financiar për krijimin e shumës 5,400,082 lekë, depozituar nga prindërit e subjektit në datën 13.6.2003 (me burim kursimet e tyre), shumë e cila është depozitë e subjektit, me gjendje aktuale 4,800,000 lekë.*

Hetimi i Komisionit

1.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e prindërve të tij³ për burimin e krijimit të kësaj shume në vitin 2003.

1.3 Në deklaratat periodike vjetore subjekti deklaron burimin e krijimit të depozitës në Raiffeisen Bank, e cila është depozita e krijuar nga prindërit e tij pranë BKT-së në vitin 2003. Deklarimet e tij janë si vijojnë:

- DIPFD 2009: *“Depozitë bankare në emër të G. Habazaj, me nr. llogarie ***, datë 13.6.2003, BKT Vlorë. Vlera: 5,400,082 lekë”.*
- DIPP 2009: *“Depozitë bankare në emër të G. Habazaj, me nr. llogarie ***, datë 13.6.2009, BKT Vlorë, është shtuar me derdhjen e datës 27.12.2009 me vlerë 25,000 lekë kursime nga rroga. Vlera: 5,425,082 lekë”.*
- DIPP 2010: *“Shumë paraje në të holla nga tërheqja e depozitës bankare dhe interesave të saj dhe kursimeve të rrogës në këtë depozitë me nr. llogarie ***, datë 13.6.2009, në BKT. Janë tërhequr në datën 30.12.2010 për në shtëpi. Vlera: 5,800,000 lekë”.*
- Pranë ILDKPKI-së (procesverbal i datave 29.9.2010, 1.2.2016 dhe 8.2.2016), subjekti ka shpjeguar: *“Për asetet e deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës, sqaroj se këto asetet më janë dhuruar nga prindërit e mi dhe si burim kanë shërbyer kursimet shumëvjeçare nga puna e tyre në sektorin privat. Dua të theksoj se babai punon në profesionin e lirë të avokatit prej 12 vitesh. Depozita është krijuar me të ardhurat e babait nga profesioni i avokatisë, ushtruar për periudhën 1998 – 1999 e në vijim. Kjo shumë më është dhuruar nga prindërit, pa kontratë dhurimi, por është depozituar në bankë në emrin tim”.*

1.4 Në deklaratat (DIPP) e viteve 2011 – 2015, subjekti deklaron gjendje *cash*, e cila ka burim tërheqjen e depozitës së kursimit nga BKT-ja në vitin 2010. Deklarimet e gjendjes *cash* të kursimeve nga subjekti dhe bashkëshortja janë si vijon:

- DIPP 2011: *“Nga shuma prej 5,800,000 lekësh e tërhequr në datën 30.12.2010 janë derdhur në llogarinë nr. *** në Raiffeisen Bank, në datën 11.2.2011, shuma 4,000 euro. Në datën 15.8.2011 nga kjo llogari është tërhequr shuma 2,000 euro. Shuma e mbetur në këtë llogari në datën 31.12.2011 është 2,000 euro”.*
- DIPP 2012: *“Shtuar gjendja cash në shtëpi në shumën 400,000 lekë nga të ardhurat personale dhe mbyllja e depozitave. Në datën 16.8.2012 është mbyllur llogaria nr. *** në*

³ Vendim nr. ***, datë 20.1.1998, për regjistrimin si person fizik të shtetasit D.A, për ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e avokatisë; vërtetim nr. ***, datë 26.2.2015, nga Bashkia Vlorë, sipas të cilit D.H është i njëjti person me D. A dhe D.A; vërtetim nr. *** datë 18.10.2016, nga DRSSH Vlorë, sipas të cilit shtetasi D.A rezulton të jetë i vetëpunësuar me NIPT ***, për periudhat 1.7.2010 – 31.12.2010, 1.4.2011 – 30.6.2011 dhe 1.10.2011 – 31.3.2012; vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016, nga DRSSH Vlorë, sipas të cilit D.A rezulton të jetë i siguruar si person fizik me nr. ***, për periudhën 16.2.1999 – 31.12.2014; vërtetim nr. ***, datë 11.10.2016 dhe nr. ***, datë 12.10.2016, nga DRT Vlorë, sipas të cilit shtetasi D.A, me NIPT ***, me veprimtari “Aktivitete juridike”, është regjistruar në regjistrat e DRT-së Vlorë në datën 27.3.2003 dhe në datën 21.4.2015 subjekti ka aplikuar për çregjistrim; ekstrakt historik i personit fizik “D. H”, me datë regjistrimi 27.3.2003 dhe status çregjistruar, në datën 11.10.2016; vërtetim nr. ***, datë 17.10.2016, nga Bashkia Vlorë, sipas të cilit D.A, me NIPT ***, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore prej vitit 1998 deri më 20.4.2015, kohë kur edhe është çregjistruar në QKR.

*Raiffeisen Bank, e cila ka qenë në vlerën 2,040 euro. Në datën 5.5.2012 është mbyllur llogaria e kursimit nr. *** në Raiffeisen Bank, në shumën 181,336.75 lekë”.*

- DIPP 2013: “Shtuar gjendja cash në shtëpi në shumën 300,000 lekë nga të ardhurat personale dhe shitja e automjetit (***, vlera 100,000 lekë)”. Ndërsa bashkëshortja deklaroi: “Gjendje cash në shumën 1,000,000 lekë. Burimi i krijimi: të ardhurat nga mësimdhënia dhe të ardhurat familjare ndër vite. Vlera: 1,000,000 lekë”.
- DIPP 2014: “Shtuar gjendja cash në shtëpi në shumën 15,000 lekë nga të ardhurat personale”.
- DIPP 2015: “Pakësuar gjendja cash në shtëpi në shumën 1,000,000 lekë. Prej pranverës së vitit 2015 banoj në apartamentin në pronësi të prindërve të mi te pallati “***” (adresa në faqen 1 të këtij deklarimi). Për mobilimin dhe shtëpiaket kam harxhuar nga gjendja cash shumën 1,000,000 lekë (sqsarime për këtë shpenzim kam dhënë edhe përpara inspektorit të ILDKPKI-se, në procesverbalet e datave 1.2.2016 dhe 8.2.2016”.
- Pranë ILDKPKI-së (sipas procesverbaleve të datave 1.2.2016 dhe 8.2.2016), subjekti ka shpjeguar për gjendjen cash: “Sqaroj se gjendja cash në datën 31.12.2014 ka qenë 6,296,336 lekë të kursyera nga unë dhe shuma 1,000,000 lekë të kursyera nga bashkëshortja. Të gjitha në total kanë qenë 7,296,336 lekë. Sot, datë 8.2.2016, kam bërë depozitim në Raiffeisen Bank të shumës 4,800,000 lekë në depozitën në emrin tim. Aktualisht kam gjendje cash në shtëpi nën shumën 1.5 milion lekë, kjo gjendje cash është ruajtur për arsye familjare (shëndetësore të bashkëshortes). Ndërsa gjendja cash në shumën prej 1,000,000 lekësh është shpenzuar në vitin 2015 për mobilimin e shtëpisë ku banoj”.

1.5 Ndërsa në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “Nga gjendja cash e parave në shtëpi është hapur në datën 8.2.2016 depozitë në Raiffeisen Bank, ku janë derdhur 4,800,000 lekë. Pakësuar gjendja cash në shtëpi: për nevoja të jetës së përditshme -178,011.75 lekë; pushime -330,000 lekë (sqarim te pjesa konfidenciale); marrja me qira dhe shpenzime për furnizim për klinikën e bashkëshortes -277,625 lekë. -178,011.75 lekë -330,000 lekë -277,625 lekë = -785,636.75 lekë”.

1.6 Historiku i depozitës pranë BKT-së (burimi i krijimit të burimit të depozitës pranë Raiffeisen Bank) – Në lidhje me depozitën e krijuar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, kur subjekti ishte duke ndjekur studimet, BKT⁴ konfirmon se kjo depozitë është çelur në datën 13.6.2003 nga depozitimi i vlerës 500,000 lekë. Gjithashtu, në vitin 2003 janë kryer edhe dy depozitime⁵ të tjera, duke e çuar në total shumën e depozituar cash në vitin 2003, në 1,192,061 lekë. Në vitin 2004 janë realizuar tri⁶ depozitime cash dhe një tërheqje në vlerën 800,000 lekë, në datën 16.9.2004. Për shumën e depozituar gjatë viteve 2003 – 2004 nuk identifikohet depozituesi i tyre. Gjatë vitit 2005 janë kryer dy depozitime⁷, me përshkrimin “D.H derdh në depozitë”, vlera e të cilave është në total 400,914 lekë. Gjithashtu, në datën 23.12.2005 shtetasi D.H tërheq shumën 2,000,000 lekë nga kjo llogari dhe në datën 18.1.2006 shuma 2,473,000 lekë transferohet nga llogaria e tij në euro brenda BKT-së. Ndërsa shtetasi

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2003, e BKT-së.

⁵ Në datën 15.9.2003, vlera 192,061 lekë dhe në datën 12.12.2003, vlera 500,000 lekë.

⁶ Në datën 16.3.2004, vlera 400,000 lekë; në datën 15.6.2004, vlera 300,000 lekë; në datën 24.9.2004, vlera 400,000 lekë.

⁷ Në datën 23.6.2005, vlera 384,979 lekë dhe në datën 23.12.2005, vlera 15,935 lekë.

D.H kryen edhe 4 depozitime⁸ *cash*, me vlerë totale 552,000 lekë, dhe tërheq nga depozita vlerën totale 2,823,644 lekë⁹.

1.7 Në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit fillon të kryejë veprime në llogarinë bankare, duke tërhequr vlerën 654,897 lekë (datë 28.9.2006) dhe gjithashtu transferon nga llogaria tjetër e tij në monedhën euro ekuivalentin e vlerës prej 4,551,000 lekësh. Kjo shumë ishte depozituar *cash* në llogarinë e kursimit të subjektit të rivlerësimit në monedhën euro¹⁰, me vlerë 37,000 euro, nga babai i tij, z. D.H, brenda muajit shtator 2006.

1.8 Në datën 3.10.2007, shtetasi D.H depoziton vlerën 94,972 lekë dhe në datën 3.10.2008 vlerën 232,611 lekë. Në datën 5.10.2009, babai i subjektit të rivlerësimit depoziton *cash* vlerën 61,828 lekë dhe në datën 7.12.2009 subjekti i rivlerësimit depoziton shumën 25,000 lekë. Shuma e depozituar nga subjekti në depozitë deklarohet prej tij në DIPP-në e vitit 2009, me burim kursimet nga paga. Nga hetimi i llogarisë pranë Raiffeisen Bank¹¹, duket se kjo vlerë ka si burim shumat e tërhequra prej tij nga llogaria e pagës pranë kësaj banke gjatë muajit nëntor 2009. Ndërsa, gjatë vitit 2010 (shkurt – tetor), subjekti i rivlerësimit depoziton vlerën totale 60,000 lekë, e cila sipas deklarimeve në DIPP-në e vitit 2010 ka burim të ardhurat e tij nga paga. Në datën 31.12.2010, gjendja e depozitës së kursimit është 5,808,831.82 lekë, e cila tërhiqet *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

1.9 Në mënyrë të përmblodhur, historiku i depozitës së kursimit është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shuma e depozituar <i>cash</i>	1,192,061	1,100,000	400,914	552,000	94,927	232,611	86,828	60,000
Shuma e transferuar nga llogaria ne Euro e subjektit e krijuar nga depozitimi i prindërve ne dt. 01.09.2006				7,024,000				
Interesi i depozites	18,149	74,826	44,049	77,541	200,074		605,642	409,888
Tërheqje <i>cash</i> nga depozita		800,000	2,000,000	3,478,541				5,894,970
Gjendja e depozitës në fund të çdo viti	1,210,210	1,585,037	30,000	4,205,000	4,500,001	4,732,612	5,425,082	0

1.10 Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, rezulton se depozitimet e kryera prej tij¹² në vitet 2009 – 2010 kanë pasur burim të ardhurat nga paga, të cilat janë tërhequr nga llogaritë e tij pranë Raiffeisen Bank.

1.11 Në lidhje me sa u shpjegua më lart, Komisioni arriti në konkluzionin se:

- Llogaria e depozitës së kursimit pranë BKT-së është çelur në vitin 2003 dhe deri në vitin 2008 vlerat e depozituara në këtë llogari janë kryer prej prindërve të subjektit të rivlerësimit, kohë gjatë së cilës subjekti ishte duke ndjekur studimet e larta.
- Përputhet deklarimi i subjekti të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010 për shumën e mbajtur si kursime *cash*, me burim tërheqjen e depozitës së kursimit pranë BKT-së.

1.12 Në lidhje me burimin e krijimit të shumave të depozituara gjatë periudhës 2003 – shtator 2009 (përpara marrjes së detyrës), Komisioni hartoi analizën financiare, në të cilën janë

⁸ Në datën 18.1.2006, vlera 247,000 lekë; në datën 19.1.2006, vlera 100,000 lekë; në datën 1.9.2006, vlera 200,000 lekë; në datën 2.10.2006, vlera 5,000 lekë.

⁹ Në datën 24.1.2006, vlerën 23,644 lekë dhe në datën 25.7.2006, vlera 2,800,000 lekë.

¹⁰ Llogari në euro, me nr. ***.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, e Raiffeisen Bank sh.a.

¹² Subjekti i rivlerësimit depoziton shumën 25,000 lekë në datën 7.12.2009 dhe gjatë periudhës shkurt – tetor 2010 depoziton vlerën totale 60,000 lekë.

përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit (personat e lidhur) dhe të ardhurat e subjektit, si më poshtë analizuar:

- *Të ardhurat nga punësimi i z. D.H gjatë periudhës janar 1994 – maj 1998 rezultojnë në vlerën totale 1,015,014 lekë sipas vërtetimeve të ISSH-së (Drejtoria Rajonale Vlorë), administruar nga dosja e subjektit A. C¹³.*
- *Të ardhurat nga pensioni i z. D.H prej nëntorit 2002, me vlerë totale 1,272,045 lekë, janë përfshirë në analizën e Komisionit sipas vërtetimit nr. **** prot., datë 19.11.2019¹⁴, të Sigurimeve Shoqërore Vlorë.*
- *Të ardhurat nga punësimi i znj. M.H prej vitit 1994, të cilat rezultojnë me vlerë totale 2,560,924 lekë sipas vërtetimeve të ISSH-së (Drejtoria Rajonale Vlorë), administruar nga dosja e subjektit A. C¹⁵.*
- *Të ardhurat nga aktiviteti i avokatisë të babait të subjektit të rivlerësimit prej muajit maj 1998 deri në shtator 2009 janë përfshirë në analizën financiare në vlerën totale 15,840,000 lekë sipas dokumentacionit të mëposhtëm:*
 - *Për periudhën maj 1998 – 2000, nga dokumentacioni¹⁶ i administruar nga dosja e subjektit A. C. (përgjigjja e DTTV-së, Bashkia Vlorë) rezulton se për periudhën 1998 – 2006 në këtë bashki nuk ka regjistra të asnjë tatimpaguesi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vendosë në dispozicion dokumentacionin në lidhje me detyrimet tatimore të paguara nga shtetasi D. H. Ndërsa në dosjen e subjektit A. C janë përcjellë 122 vendime të periudhës korrik 1998 – dhjetor 2002, në të cilën dokumentohet se shtetasi D.H ka qenë avokat i palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, nga vërtetimi i ISSH Vlorë¹⁷ dhe përgjigjet e pyetësorëve nga dosja e administruar rezulton se shtetasi D.H ka qenë i siguruar prej vitit 1999 si person fizik dhe ka shlyer pagesat për sigurim vullnetar për pension pleqërie.*

1.13 Në vijim të sa më sipër, në analizën e Komisionit është konsideruar si qarkullim i aktivitetit gjatë kësaj periudhë kohore vlera 2,000,000 lekë për çdo vit, duke konsideruar se ajo është fasha minimale e të ardhurave nga biznesi për të cilën detyrimet tatimore kanë qenë në administrim të pushtetit vendor (DTTV, Bashkia Vlorë), për të cilat nuk ka të dhëna të regjistruara nga institucioni për asnjë tatimpagues të kohës, por ndërkohë është provuar kryerja e aktivitetit nga kopja e vendimeve të gjykatës dhe pagesa e sigurimeve vullnetare për pension për shtetasin D.H. Ndërsa e ardhura e përfshirë në analizë është llogaritur me marzh fitimi 80%, mbështetur në praktikën e konsoliduar të Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për aktivitetin e avokatisë. E ardhura e përfshirë për periudhën 1999 – 2000 është 1,600,000 lekë për çdo vit, ndërsa për qarkullimin e aktivitetit për vitin 1998, sipas shpjegimeve¹⁸ të përcjella në dosjen e administruar, është shpjeguar se vlera e tij është 800,000 lekë dhe e ardhura e ligjshme në analizë është përfshirë në vlerën 640,000 lekë (800,000 lekë * 80%).

¹³ Shihni shkresat bashkëlidhur pyetësorit datë 19.9.2019.

¹⁴ Shihni shkresën e administruar nga dosja e subjektit të rivlerësimit A. C, nr. *** prot., datë 22.11.2019.

¹⁵ Shihni shkresat bashkëlidhur pyetësorit datë 19.9.2019.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2019, të Bashkisë Vlorë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 14.11.2019).

¹⁷ Administruar nga dosja e subjektit A. C, nr. *** prot., datë 21.10.2014, përcjellë me përgjigjet e pyetësorit datë 19.9.2019.

¹⁸ Përgjigjet e përcjella nga subjekti në dosjen e administruar në datën 22.10.2019.

- *Për periudhën 2001 – 2004*, DRT Vlorë¹⁹ informon se D.A (H), me NIPT ***, është regjistruar me vendim gjykate datë 20.7.1998 dhe ka shlyer detyrimet tatimore për periudhën 1999 – 2002 për “Tatim biznesi i vogël profesion i lirë” dhe për periudhën 2003 – 2004 ka kryer pagesa për “Tatim i thjeshtuar + taksë vendore biznes i vogël”. Gjithashtu, rezulton se qarkullimi i deklaruar për periudhën 2001 – 2004 nga shtetasi D.H ka qenë: viti 2001, qarkullimi 2,250,000 lekë; viti 2002, qarkullimi 2,000,000 lekë; viti 2003, qarkullimi 1,000,000 lekë; viti 2004, qarkullimi 2,000,000 lekë.
Për vitin 2001 llogaritjet në analizën financiare janë kryer duke konsideruar fashën minimale të qarkullimit prej 2,000,000 lekësh, e cila ka qenë objekt vetëm i tatimeve dhe taksave vendore. Mbi këtë fashë subjektet ishin objekt i deklarimit të tatimit të thjeshtuar, për të cilën nuk u arrit të provohej shlyerja e tij në këtë vit.
- *Për periudhën 2005 – 2006*, në vijim të sqarimeve të trajtuara më lart (për vitet 1998 – 2000), e ardhura e përfshirë në analizën e Komisionit është llogaritur me marzh 80% të fashës minimale të qarkullimit, i cili ishte objekt i detyrimeve tatimore të administruara nga pushteti lokal. Në dosjen e administruar përcillet vërtetimi i Bashkisë Vlorë²⁰, sipas të cilit “D.H”, person fizik, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për periudhën 1998 – 20.4.2015.
- *Për periudhën 2007 – 2009*, qarkullimi është vlerësuar nga DTTV, Bashkia Vlorë²¹. Sipas vërtetimit në vitin 2007, xhiroja e vlerësuar është 2,000,000 lekë dhe janë shlyer taksat vendore dhe të biznesit të vogël. Për vitin 2008, xhiroja e vlerësuar nga specialisti është në vlerën 3,000,000 lekë dhe informohemi për shlyerjen e taksave vendore dhe të biznesit të vogël. Për vitin 2009 nuk përcillet informacion mbi xhiron e vlerësuar apo për taksat vendore. Pra, në analizën e Komisionit për vitin 2007 është përfshirë si e ardhur 80% e qarkullimit prej 2,000,000 lekësh; për vitin 2008 është llogaritur 80% e fashës minimale 2,000,000 lekë, subjekt i detyrimeve tatimore të pushtetit vendor, pasi nuk u provua shlyerja e tatimit të thjeshtuar pranë DRT-së. Ndërsa për vitin 2009 nuk janë përfshirë të ardhura, pasi nuk përcillet informacion për shlyerje detyrimesh tatimore, taksa apo edhe të të dhënave të tjera financiare të aktivitetit.
- Në analizë janë përfshirë edhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga bursa në Shkollën e Magjistraturës dhe kthimi i huas nga shtetasi A. C. gjatë periudhës 2007 – 2009, për të cilën rezultoi në analizën financiare në dosjen e administruar se ka pasur mundësi ta kthejë vlerën e huas.
- Ndërsa si investim është përfshirë vlera e ndërtimit të shtesës në vitin 1997 prej 1,336,580 lekësh, për të cilën është plotësuar formulari i vetëdeklarimit në vitin 2005 nga prindërit e subjektit, dhe dhënia e vlerës 3,000,000 lekë hua në vitin 2003 shtetasit A. C., nga dosja e administruar.
- Gjithashtu, nga dosja e administruar²² rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur depozitë pranë Raiffeisen Bank nga viti 1997, me vlerë fillestare 1,300,000 lekë, deri në vitin 2002, me vlerë 5,217,102 lekë, e cila u përfshi në analizën e mëposhtme.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2023.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2016, Bashkia Vlorë, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, dosja ILDKPKI, aneks nr. ***, e cila është përcjellë edhe me përgjigjet e pyetësorit datë 19.9.2019, në dosjen e administruar.

²¹ Shihni shkresën e administruar nga dosja e subjektit të rivlerësimit A. C, nr. *** prot., datë 14.10.2019.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019, e Raiffeisen Bank, përcjellë me përgjigjet e subjektit datë 22.10.2019.

1.14 Në analizën financiare, shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 3 anëtarë, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, i cili ka qenë në një certifikatë familjare me prindërit dhe jetonte me ta, sipas deklarimeve të tij në pyetësorin standard.

1.15 Në vijim është paraqitur analiza kumulative për periudhën 1994 – shtator 2009, për të hetuar mundësinë e krijimit të depozitës pranë BKT-së nga prindërit e subjektit të rivlerësimit.

Analiza financiare kumulative	Vitet 1994 – shtator 2009
TË ARDHURAT	25,812,471 lekë
Bursë studimi nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2007 – 2009. Shuma 1,004,115 lekë.	1,004,115 lekë
Të ardhura nga marrëdhënia e punësimit e babait të subjektit 1994 – maj 1998	1,015,014 lekë
Të ardhura nga aktiviteti i avokatisë të babait të subjektit të rivlerësimit	15,840,000 lekë
Të ardhura nga marrëdhënia e punësimit e nënës së subjektit për periudhën maj 1994 – shtator 2009	2,560,924 lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit	1,272,045 lekë
Të ardhura nga depozitat në OTP Bank	224,172 lekë
Të ardhura nga depozitat në Alpha Bank	378,000 lekë
Të ardhura nga depozitat në RBAL Bank	1,327,473 lekë
Të ardhura nga depozitat në Union Bank	669,843 lekë
Të ardhura nga depozitat në BKT	20,886 lekë
Kthimi i huas shtetasit A. C.	1,500,000 lekë
PASURI	24,699,200 lekë
Shtesa/pakësime të likuiditeteve në bankë në llogaritë e prindërve	15,310,743 lekë
Ndryshimi i gjendjes së depozitës së krijuar nga prindërit në emër të subjektit të rivlerësimit	4,794,440 lekë
Blerja e automjetit tip “***”, me burim kursimet e prindërve	257,438 lekë
Ndërtimi i shtesës së pallatit me legalizim	1,336,580 lekë
Hua dhënë shtetasit A. C.	3,000,000 lekë
SHPENZIMET	3,813,045 lekë
Shpenzime jetike 30% (1994 – 1998)	426,121 lekë
Shpenzime jetike (1999 – shtator 2009)	3,386,924 lekë
Rezultati financiar	- 2,699,775 lekë

1.16 Duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme depozitën bankare në emër të subjektit pranë BKT-së, në vlerën totale 2,699,775 lekë.

1.17 Në DIPP-në e vitit 2013, bashkëshortja e subjektit deklaroi 1,000,000 lekë kursime *cash*, me burim pagën pranë U.A.T , dhe dhuratë nga prindërit si kontribut për martesën. Në deklaratën *Vetting* saktëson vlerat, ku përkatësisht nga paga e saj është kursyer *cash* vlera 123,499 lekë dhe kontributi i prindërve i dhuruar ka qenë 876,501 lekë. Sa rezultuar nga ISSH-ja²³, vlera e përfituar nga bashkëshortja nga të ardhurat nga paga në vitin 2013 ka qenë 333,072 lekë, e cila rezulton e mjaftueshme për të kursyer vlerën e deklaruar prej 123,499 lekësh²⁴. Ndërsa, në lidhje me kontributin e prindërve, të dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni hartoi analizën financiare si në vijim, nga e cila rezulton se ata kanë pasur mundësi t’i dhurojnë vajzës së tyre vlerën 876,501 lekë, si dhuratë për martesë.

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2023, e ISSH-së.

²⁴ Shpenzimet jetike për një anëtar në vitin 2013 janë 141,024 lekë. Pra, vlera e mundshme për t’u kursyer vetëm në këtë vit është 192,048 lekë.

Analiza financiare kumulative	Vitet 2003 – 2012
TË ARDHURAT	3,561,658 lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të bashkëshortes	911,606 lekë
Të ardhura nga paga e babait të bashkëshortes, transferuar pranë RBAL Bank dhe vërtetim i DRSSH-së	2,207,542 lekë
Të ardhura nga paga e nënës së bashkëshortes, transferuar pranë RBAL Bank	442,510 lekë
SHPENZIMET	2,459,380 lekë
Shpenzime jetike	2,459,380 lekë
Rezultati financiar	1,102,278 lekë

1.18 Duket se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi të dhurojnë vlerën e deklaruar prej saj.

1.19 Në vijim, subjekti deklaron në DIPP-në e viteve 2010 – 2015 shtesa/pakësime të kursimeve *cash* të mbajtura prej tij, të cilat janë përfshirë në analizën financiare si vijon:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendja cash e kursimeve	5,800,000 Lekë	5,523,400 Lekë	5,923,400 Lekë	7,223,400 Lekë	7,296,336 Lekë	6,296,336 Lekë	710,699 Lekë

1.20 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti, sipas procesverbaleve të ILDKPKI-së (datë 1.2.2016), ku është pyetur për gjendjen *cash* që disponon në banesë deri në datën 31.12.2014 dhe nëse kjo vlerë kalon shumën 1.5 milionë lekë të depozitohet në sistemin bankar, ka depozituar në Raiffeisen Bank²⁵ vlerën 4,800,000 lekë, në datën 8.2.2016, dhe sqaron: “...aktualisht kam gjendjen *cash* në shtëpi nën shumën 1.5 milionë lekë. Kjo gjendje *cash* është ruajtur për arsye familjare, shëndetësore të bashkëshortes. Ndërsa, gjendja *cash* në shumën prej 1,000,000 lekësh është shpenzuar në vitin 2015 për mobilimin e shtëpisë ku banoj aktualisht”. Gjithashtu, edhe në DIPP-në e vitit 2016 subjekti deklaron këtë veprim.

Raiffeisen Bank konfirmon deklaratimet e subjektit dhe shumën e depozituar prej tij në këtë bankë, në datën 8.2.2016.

1.21 Gjithashtu, në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, me vlerë 700,000 lekë, nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se gjendja e kursimeve *cash* në datën 31.12.2016 ka qenë 710,699 lekë.

- Në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash*, nuk u konstatuan problematika.

1.22 Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se:

- Depozita e kursimit pranë BKT-së në emër të subjektit të rivlerësimit është krijuar përpara marrjes së detyrës prej tij.
- Prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur mundësi të krijojnë depozitën e kursimit për subjektin me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me pamundësi financiare në shumën -2,699,775 lekë.

1.23 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i kaloi barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, e Raiffeisen Bank.

1.24 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “Në lidhje me depozitën bankare, dua të sjell në vëmendje të Komisionit se ajo është krijuar së pari para fillimit të detyrës, por edhe në një kohë që unë kam qenë ende student në universitet, viti I, moshë 19 vjeç.

Gjithashtu, konstatoj se nga analiza financiare prindërve të mi ju është ngarkuar një rezultat negativ i viteve 1997, 1999 dhe 2003, duke e mbartur këtë rezultat edhe në vitet pasardhëse.

Ky rezultat vjen nga një llogaritje, e cila nuk ka konsideruar situatën faktike se shuma e parave ka qenë aty, është në sistemin bankar (provuar me statement bankar dhe librezën e kursimeve). Kjo depozitë ka ekzistuar përpara fillimit të punës si prokuror, në tetor 2009.

Burimet e krijimit të kësaj pasurie janë:

a) Të ardhurat nga punësimi i babait tim, z. D.H, gjatë periudhës janar 1994 – maj 1998. Sipas përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, ato rezultojnë në vlerën totale 1,015,014 lekë, sipas vërtetimeve të ISSH-së, Drejtoria Rajonale Vlorë.

*Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i babait tim për periudhën objekt analize, konstatoj se ato nuk janë në përputhje me përlllogaritjet e kryera sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 9.1.2024, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Vlorë²⁶. Referuar këtij dokumentacioni, rezultojnë se të ardhurat e përfituara nga babai im, z. D.H, deri në vitin 2008 janë në shumën 1,118,253 lekë.*

b) Të ardhurat nga punësimi i nënës sime, znj. M.H, prej vitit 1994 deri në shtator 2009. Sipas përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni ato rezultojnë në vlerën totale 2,560,924 lekë, sipas vërtetimeve të ISSH-së, Drejtoria Rajonale Vlorë.

*Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i nënës sime për periudhën objekt analize, konstatoj se ato nuk janë në përputhje me përlllogaritjet e kryera sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 9.1.2024, të ISSH-së, Drejtoria Rajonale Vlorë²⁷. Referuar këtij dokumentacioni, rezultojnë se të ardhurat e përfituara nga nëna ime, znj. M.H, janë në masën 2,704,170 lekë”.*

1.25 Subjekti bashkëlidhi me parashtrimet vërtetimin nr. *** prot., datë 9.1.2024, të ISSH-së, DRT Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet paga bruto e marrë prej prindërve të subjektit gjatë periudhës 1994 – 2009. Komisioni përditësoi analizën financiare për të ardhurat nga punësimi të prindërve të subjektit të rivlerësimit sipas vërtetimit të përcjellë, duke llogaritur pagën neto, dhe ndryshoi të ardhurat e nënës së subjektit në periudhën 1994 – 2003 dhe në vitin 2007, ndërsa për babain e tij analiza u përditësua për vitet 1994 – 1998, duke përfshirë në analizë vlerën e shpërblimit për çdo vit, përkatësisht: të ardhurat nga punësimi të babait për këtë periudhë janë në vlerën 1,118,253 lekë dhe për nënën në vlerën 2,524,705 lekë.

*c) Për të ardhurat nga aktiviteti i avokatisë të babait të tij prej muajit maj 1998 deri në shtator 2009. Subjekti ka parashtruar në përgjigje të rezultateve të hetimit, duke deklaruar se ai ka ushtruar aktivitet ekonomik privat si “Avokat”, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 20.7.1998. Për këtë aktivitet ai është pajisur me certifikatë regjistrimi në organin tatimor, me kod fiskal ***, nga dega e Tatim-Taksave Vlorë. Profesionin e avokatisë është rregulluar me një ligj të posaçëm, nr. 9109, datë 17.7.2003, në vitin 2003, dhe në përputhje me këtë ligj babai i tij është regjistruar si person fizik pranë QKB-së në datën 27.3.2003, me NIPT ***.*

²⁶ Bashkëngjitur papësimëve, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto.

²⁷ Bashkëngjitur subjekti ka sjellë vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto.

Për vitet 1998 – 2004

Subjekti përcolli me parashtrimet e tij përfundimtare dokumentacionin, i cili provoi pagesën e tatimeve, taksave lokale etj., nga babai i tij për këtë periudhë. Ai sqaroi se: *“Referuar dokumentacionit analitik²⁸ mbi pagesat e tatimeve dhe taksave vendore (bashkëngjitur mandatpagesat e taksave dhe tatimeve për periudhën 1998 – 2004) përfshihen edhe mandatpagesa të detyrimeve të tjera, si pagesa për taksë regjistrimi (avokati)²⁹, taksë pastrimi, taksë solidariteti, pagesa të sigurimeve shoqërore³⁰ etj. Pra, rezultojnë të dhëna mbi pagesat analitike të kryera nga subjekti fizik “D.H ” për periudhën 1998 – 2004. Gjithashtu, z. D.H ka qenë i siguruar prej vitit 1999 si person fizik dhe ka shlyer pagesat për sigurim vullnetar për pension pleqërie”.*

Për vitet 2001 – 2004

Ndërsa për këto vite subjekti solli shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.1.2024, nga Drejtoria Rajonale Vlorë, nga e cila rezulton se nga verifikimi në dosjen fizike të subjektit xhiroja vjetore e deklaruar nga ana e tij për vitet 2001 – 2004 është si më poshtë:

- viti 2001, qarkullimi 2,000,000 lekë;
- viti 2002, qarkullimi 2,000,000 lekë;
- viti 2003, qarkullimi 1,500,000 lekë;
- viti 2004, qarkullimi 2,000,000 lekë.

*Për sa i përket xhiros vjetore të deklaruar për vitin 2001 është i drejtë konstatimi i Komisionit se llogaritjet në analizën financiare për vitin 2001 janë kryer duke konsideruar fashën minimale të qarkullimit prej 2,000,000 lekësh, e cila ka qenë objekt vetëm i tatimeve dhe taksave vendore. Kjo mbështetur edhe në deklaratën e xhiros vjetore në dosjen tatimore, e cila nuk është shifra 2,250,000, por 2,000,000 lekë. Ndërsa, referuar dokumentacionit analitik të qarkullimit të realizuar dhe mbi të cilin janë kryer pagesat e tatimeve dhe taksave vendore rezulton se qarkullimi gjithsej i realizuar vjetor për vitin 2003 është 1,500,000 lekë, ndryshe nga sa e ka përlllogaritur Komisioni. Sa më sipër, konfirmohet xhiroja e realizuar për këtë periudhë. Në shkresën nr. *** prot, datë 10.10.2023, që DRT Vlorë i ka dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për vitin 2003, xhiroja është 1,000,000 lekë, ndërsa në shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, që më ka dërguar mua, xhiroja është 1,500,000 lekë. Edhe në dokumentacionin e dosjes së tatimeve për D.H rezulton 1,500,000 lekë.*

Lidhur me të ardhurat neto nga aktiviteti i avokatisë së babait tim, nuk jam dakord me përlllogaritjen e kryer në analizë nga Komisioni, sepse nga aktiviteti dhe me provat që po ju vë në dispozicion dhe bazuar në përlllogaritjet nuk mund të gjendemi në kushtet e aplikimit të marzhit të fitimit 80%, pasi rasti konkret nuk është i njëjtë me “eksperiencat me subjekte të tjera”, siç janë llogaritjet nga Komisioni. Avokatia nuk ka kosto të tjera, për sa kohë babai im nuk ka paguar qira për selinë ku ushtronte aktivitetin e tij. Bazuar në vlerën e detyrimeve tatimore të paguara nga subjekti në periudhën 2003 – 2004 (taksa, tatime, pagesa për sigurimet shoqërore),

²⁸ Bashkëlidhur parashtrimeve shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.1.2024, nga DRT Vlorë; mandatarëtimi nr. ***, datë 11.9.1998, nga Banka e Kursimeve.

²⁹ Bashkëlidhur prapësimeve vërtetimi nr. ***, datë ...1998, nga Zyra e Taksave, Drejtoria Rajonale Vlorë; autorizimi për regjistrimin në Zyrën e Tatimeve-Taksave Vlorë, datë 8.2.1999.

³⁰ Bashkëlidhur prapësimeve, vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të Sigurimeve Shoqërore, me nr. ***, datë 8.2.1999, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë etj.

rezulton se të ardhurat neto të tij nga ushtrimi i profesionit të avokatit për këtë periudhë janë në shumën 11,793,308 lekë, ndërsa marzhi i fitimit mesatar faktik për këto vite është 93.7%.

1.26 Për vitet 2001 – 2004, pas shpjegimeve dhe dokumentacionit të përcjellë nga subjekti me parashtrimet, duke iu referuar edhe praktikës së Komisionit dhe të Kolegjit, Komisioni përditësoi analizën financiare, duke bërë ndryshim në vlerën e qarkullimit të vitit 2003 sipas vërtetimit të DRT Vlorë, duke rillogaritur të ardhurat nga avokatia e babait të subjektit me marzhin e fitimit 90%.

Për vitet 2005 – 2009

Për këto vite subjekti parashtrori si vijon: “Për vitet 2005, 2006 e në vijim, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr. 9431, datë 13.10.2005, neni 1, përcaktohet se shkalla tatimore e tatimfitimit të thjeshtuar është 1.5%. Pra, pavarësisht shpenzimeve të subjektit, tatimi llogaritet mbi të ardhurën e deklaruar e, për këtë arsye, llogaritja e shpenzimeve nuk ndikon për efekt të tatimfitimit të thjeshtuar.

Në vitin 2007 ka hyrë në fuqi ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre”. Kompetencat për administrimin e taksës vendore i kaloi totalisht zyrave të taksave dhe tarifave vendore të Njësive të Qeverisjes Vendore, kurse përgjegjësia tatimore e tatimit të thjeshtuar për vitin 2007 është shfuqizuar, të dhënat për të ardhurat e realizuara subjekti i deklaroi në zyrën e taksave vendore të Njësive të Qeverisjes Vendore.

Për periudhën 2007 – 2009, qarkullimi është vlerësuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë. Sipas vërtetimit në vitin 2007, xhiroja e vlerësuar është 2,000,000 lekë dhe janë shlyer taksat vendore dhe të biznesit të vogël. Për vitin 2008, xhiroja e vlerësuar nga specialisti është në vlerën 3,000,000 lekë. Për këtë periudhë konfirmohet shlyerja e taksave vendore dhe të biznesit të vogël. Nga ana e Komisionit është kryer përlllogaritje për fashën e xhiros së vlerësuar të qarkullimit prej 2,000,000 lekësh dhe të ardhurën neto në 80% të qarkullimit”.

1.27 Në referim të dokumentacionit të paraqitur mbi qarkullimin e realizuar për vitet 2007 dhe 2008 dhe konfirmuar nga DTTV, Bashkia Vlorë, subjekti i ka kërkuar Komisionit të përfshijë në llogaritje xhiron e vlerësuar dhe të konfirmuar nga organet tatimore, për sa kohë konfirmohet pagesa e tatimeve dhe taksave në atë periudhë.

1.28 Ndërsa, lidhur me të ardhurat neto për vitet 2007 – 2008 nga aktiviteti i avokatisë së babait, subjekti ka pretenduar se Komisioni ka kryer përlllogaritje të gabuara të fitimit nga aktiviteti, për sa i përket aplikimit të marzhit të fitimit në masën 80%, pasi rasti konkret nuk është i njëjtë me “eksperiencat me subjekte të tjera”. Duke vlerësuar aktivitetin e kryer në periudhat e mëparshme mbi xhiron e qarkullimit, e konfirmuar nga organet tatimore, marzhi i fitimit që duhet të aplikohet është jo më pak se 90% e qarkullimit të realizuar. Bazuar në vlerën e detyrimeve tatimore të paguara nga subjekti në periudhën 2007 – 2008, rezulton se të ardhurat neto nga ushtrimi i profesionit të avokatit për këtë periudhë janë në shumën 8,100,000 lekë, llogaritur me marzhin e fitimit 90% të xhiros së realizuar.

1.29 Subjekti kërkoi që të ardhurat neto nga aktiviteti i avokatisë të babait të tij të llogariten në shumën 19,643,308 lekë, për periudhën maj 1998 – shtator 2009.

1.30 Komisioni përditësoi analizën financiare për vitet 2005 – 2006, duke rillogaritur të ardhurat nga avokatia e babait të subjektit me marzhin e fitimit 90%, duke u bazuar në shpjegimet dhe dokumentacionin e sjellë nga subjekti bashkëlidhur parashtrimeve, si dhe sipas praktikës së Komisionit dhe Kolegjit.

1.31 Në përfundim, Komisioni konkludoi se të ardhurat totale nga avokatia të babait të subjektit për periudhën 1998 – 2008 janë në vlerën 18,270,000 lekë (në ndryshim nga vlera prej 15,840,000 lekësh, e përcjellë në rezultate hetimi). Kjo vlerë u përfshi në analizën financiare të Komisionit.

d) Subjekti listoi të ardhurat nga interesat bankarë gjatë periudhës nga depozitat bankare, të llogaritura nga Komisioni, si vijon:

- depozitat në DTP Bank, në shumën 224,172 lekë;
- depozitat në Alpha Bank, në shumën 378,000 lekë;
- depozitat në Raiffeisen Bank, në shumën 1,327,473 lekë;
- depozitat në BKT, në shumën 669,843 lekë.

Por, ai pretendon se nga verifikimi i llogarisë bankare pranë Societe Generale Bank, sipas shkresës nr. *** prot., për llogarinë nr. *** ALL *** në emër të M.H ose D.H , për periudhën 18.4.2005 – 22.12.2008, janë identifikuar 421.621,72 lekë të ardhura nga interesat.

1.32 Subjekti në shpjegimet e tij citon përgjigjen e Societe Generale Bank (aktualisht përthithur nga OTP Bank), e cila ka qenë pjesë e dosjes së subjektit A. C. Në këtë përgjigje të bankës konfirmohet shuma e derdhur *cash* në datën 18.4.2005, me vlerë 1,000,000 lekë, e cila më pas është mbyllur si depozitë kursimi dhe ka qëndruar si e tillë deri më 18.4.2007. Ndërsa pas një viti, në datën 18.4.2006 është depozituar *cash* edhe vlera 137,000 lekë, e cila i është shtuar depozitës fillestare të investuar në vitin 2005. Në datën 18.4.2007 është maturuar vlera e të dyja depozitave.

1.33 Komisioni ka përfshirë në analizën e tij (dërguar me rezultatet) të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit sipas përgjigjes së OTP Bank³¹, e cila konfirmon se të ardhurat nga interesat në vitin 2006 janë 63,000 lekë; në vitin 2007 janë 147,646 lekë (datë 18.4.2007, vlera bruto 72,000 lekë dhe 46,026 lekë); në vitin 2008 janë 13,525 lekë (datë 21.10.2008, vlera bruto 7,623 lekë dhe 7,405 lekë). Ndërsa për vitin 2008, përveç vlerës 13,525 lekë, për të cilën përputhen shpjegimet e subjektit me çfarë është përcjellë në rezultate, rezulton edhe një vlerë tjetër të ardhurash nga interesi në datën 18.10.2008, në vlerën 101,873 lekë, e cila vjen prej maturimit të depozitës me vlerë 1,741,423 lekë, e çelur në datën 18.10.2007 dhe maturuar në datën 21.10.2008.

Komisioni për këtë vit (2008) ka bërë përditësim të analizës financiare, ndërsa për periudhat e tjera vlerat mbeten të njëjta.

- Sipas subjektit, të ardhura të tjera nga interesat, të cilat Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare, janë edhe të ardhurat nga interesat e depozitave në llogarinë bankare nr. llogarie ***, pranë BKT-së, të cilat janë burim krijimi (shtim i vlerave) për këtë depozitë.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2023, e OTP Bank.

Totali i të ardhurave nga interesat deri në datën 9.10.2009 pranë kësaj llogarie janë në shumën 1.020.238,13 lekë.

1.34 Komisioni pas përcjelljes së provave dhe shpjegimeve përfshiu në analizën financiare të ardhura nga depozitat e kursimit pranë BKT-së, për periudhën 2003 – 2009, me vlerë totale 1,020,238 lekë.

e) *Vlera 3,000,000 lekë, dhënë hua nga prindërit shtetasit A. C.*

Subjekti ka parashtruar se: *“Në analizë shkruhet se prindërit e mi i kanë dhënë në vitin 2003 shtetasit A. C. shumën prej 3,000,000 lekësh hua dhe, meqenëse i kanë dhënë këtë hua, nuk kishin mundësi të më kalonin shumë parash në depozitë dhe se A. C. deri në vitin 2009 u ka shlyer 1,500,000 lekë.*

Depozita në BKT dyemërore D dhe Gentjan Habazaj është hapur në datën 13.6.2003 dhe me kalimin e viteve, për shkak të derdhjeve të babait tim dhe interesave, është maturuar deri në shumën 5,400,082 lekë, në shtator të vitit 2009”.

Komisioni, në vendimin e tij nr. 243, datë 4.3.2020, për subjektin A. C., ka arritur në konkluzionin se: *“41. Mbështetur në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar se ka shlyer në vijimësi këtë hua. Nga një analizë mekanike e kryer nga Komisioni rezulton e provuar potencialisht mundësia për kthimin e kësaj huaje. Por as në rastin e marrjes së huas dhe as në rastin e kthimit të saj pjesërisht apo në përfundim të likuidimit të saj, bashkëshortët C nuk kanë paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor provues të kohës, përveç deklarimeve të tyre për të provuar marrjen apo kthimin përkatësisht sipas vlerave të deklaruara prej tyre në deklaratimet periodike. Në një vlerësim të kësaj situatë, referuar marrëdhënies së tyre të posaçme me huadhënësin, kjo nuk përbën një detyrim ligjor, por në vlerësim të trupit gjykues dokumentimi i tyre gjatë kohës së marrjes dhe dhënies do të ndikonte në krijimin e bindjes së brendshme për anëtarët e trupit gjykues mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.*

Ndërsa, Kolegji në vendimin nr. 1, datë 17.1.2023, për subjektin A. C., ka arritur në përfundimin se i ndjeri D.H ka pasur mundësi për dhënien e huas në shumën 3,000,000 lekë. Në tërësi të analizës së mësipërme duhet të vlerësohet e të pranohet në favorin tim se prindërit e mi kishin mundësinë të krijojnë shumën 3,000,000 lekë dhe se këtë shumë nuk e kanë dhënë hua. Kjo shumë prej 3,000,000 lekësh duhet të shtohet si e ardhur e prindërve të mi për periudhën 1994 – shtator 2009”.

f) *Në lidhje me shumën 1,336,580 lekë për ndërtimin e shtesës së pallatit, për vitet 1997 - 1998, subjekti ka parashtruar se: “Së bashku me fqinjët tanë, diku nga fundi i vitit 1997 filloi ndërtimi i shtesës së pallatit ku ne banonim në qytetin e Vlorës dhe përfundoi në vitin 1998. Në atë kohë kam qenë nxënës në shkollën 8-vjeçare. Sipas llogaritjes së Komisionit, për ndërtimin e shtesës janë shpenzuar 1,336,580 lekë. Kjo shumë në analizën e Komisionit, në interpretim të gabuar logjik e ekonomik, mbartet në vitet në vazhdim si gjendje minus deri në vitin 2003. Sipas logjikës ekonomike ndër vite mbarten kursimet dhe jo harxhimet e bëra. Shuma prej 1,336,580 lekësh e vitit 1997 nuk duhet të llogaritet aspak, kur ndërkohë depozita bankare në BKT është hapur vite më pas në vitin 2003, nuk mund të ngarkohen rezultate negative dhe të kompensohen me të ardhura të viteve në vazhdim, kur kemi të bëjmë me individ dhe jo biznes”.*

1.35 Komisioni, duke u mbështetur në praktikën e tij, vlerësoi të përfshijë në analizën financiare vlerën e investuar në ndërtimin e shtesës së pallatit, ashtu siç është reflektuar në rezultatet e hetimit.

g) Për të ardhurat nga depozita bankare tek ish-Banka e Kursimeve, subjekti ka parashtruar se me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2023, të Raiffeisen Bank, janë nxjerrë të dhënat për depozitën e kursimit në ish-Bankën e Kursimeve me nr. ***, Agjencia nr. ***, dega Vlorë dhe, për këtë arsye, kërkon të merren në konsideratë nga Komisioni të ardhurat nga interesat e depozitave për periudhën 1.6.2000 – 18.9.2002, me vlerë totale 169,620 lekë.

1.36 Komisioni përfshiu në analizën e tij vlerat e të ardhurave nga interesat e depozitave sipas përgjigjes së përcjellë nga Raiffeisen Bank, me parashtrimet e subjektit.

Sa më lart, pas shpjegimeve të subjektit, si dhe provave të përcjella prej tij, analiza financiare e krijimit të depozitës rezultoi me mundësi financiare, me rezultat financiar (mundësi kursimi) në fund të shtatorit 2009 prej 1,067,952 lekësh.

Analiza financiare kumulative	Vitet 1994 – shtator 2009
Të ARDHURAT	29,601,223 lekë
Bursë studimi nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2007 – 2009. Shuma 1,004,115 lekë.	1,004,115 lekë
Të ardhura nga marrëdhënia e punësimit e babait të subjektit të rivlerësimit 1994 – maj 1998	1,118,253 lekë
Të ardhura nga aktiviteti i avokatisë të babait të subjektit të rivlerësimit	18,270,000 lekë
Të ardhura nga marrëdhënia e punësimit e nënës së subjektit për periudhën maj 1994 – shtator 2009	2,524,705 lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit	1,272,045 lekë
Të ardhura nga depozitat në OTP Bank	326,045 lekë
Të ardhura nga depozitat në Alpha Bank	378,000 lekë
Të ardhura nga depozitat në RBAL Bank	1,327,473 lekë
Të ardhura nga depozitat në Union Bank	669,843 lekë
Të ardhura nga depozitat në BKT	1,041,124 lekë
Të ardhura nga depozitat në Bankën e Kursimeve	169,621 lekë
Kthimi i huas shtetasit A. C.	1,500,000 lekë
PASURI	24,699,200 lekë
Shtesa/pakësime të likuiditeteve në bankë në llogaritë e prindërve	15,310,743 lekë
Ndryshimi i gjendjes së depozitës së krijuar nga prindërit në emër të subjektit të rivlerësimit	4,794,440 lekë
Blerja e automjetit tip “***”, me burim kursimet e prindërve	257,438 lekë
Ndërtimi i shtesës së pallatit me legalizim	1,336,580 lekë
Hua dhënë shtetasit A. C.	3,000,000 lekë
SHPENZIMET	3,834,071 lekë
Shpenzime jetike 30% (1994 – 1998)	451,590 lekë
Shpenzime jetike	3,382,480 lekë
Rezultati financiar	1,067,952 lekë

1.37 Në përfundim, Komisioni, referuar shpjegimeve me shkrim të subjektit, provave të sjella, duke iu referuar tabelës së përditësuar të analizës financiare për vitet 1994 – 2009, arriti në konkluzionin se prindërit e subjektit kishin mundësi për krijimin e depozitës në vitin 2003 prej 5,400,082 lekësh, duke zbritur shpenzimet e jetesës.

2. Apartament banimi në Tiranë, në përdorim, blerë nga nëna e subjektit

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se banon në apartamentin me adresë rruga “****”, Tiranë, hyrja ***, apartamenti nr. ***, nr. pasurie ***, me sip. 93.51 m², blerë nga prindërit nga kursimet e tyre në datën 17.1.2014, kundrejt çmimit 72,270 euro. Ky apartament i është dhënë në përdorim nga prindërit.

Subjekti banon në këtë apartament prej vitit 2015.

2.1 ILDKPKI-ja ka konstatuar: *Mungesë dokumentacioni justifikues financiar për burimin e krijimit në vitin 2014 të apartamentit me sip. 93.51 m², rruga “****”, Tiranë, në vlerën 72,270 euro, nga prindërit e subjektit me kursimet e tyre.*

Hetimi i Komisionit

2.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar përdorimin e këtij apartamenti në DIPP-në e vitit 2015, si vijon: *“Prej pranverës së vitit 2015 banoj në apartamentin në pronësi të prindërve të mi te pallati “****” (adresa pallati “****”, shk. ***, ap. ***, tek ***, Tiranë)...*”. Gjithashtu, adresën e apartamentit e deklaroi edhe në deklaratat në vijim.

2.3 Sipas certifikatës³² për vërtetim pronësie të datës 6.1.2015 dhe kartelës së pasurisë për apartamentin me sip. 93.51 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, rezultoi se apartamenti është regjistruar në emër të shtetasës M.H (nëna e subjektit). Shuma e shlyer për këtë pasuri ka qenë 72,270 euro. Ndërsa, kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2014, përcjellë nga subjekti me deklaratën *Vetting*, rezultoi se është lidhur midis shtetasve M dhe D.H , në cilësinë e palës porositëse, dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës sipërmarrëse. Prindërit e subjektit me anë të kësaj kontrate kanë porositur apartamentin me sipërfaqe totale 104.26 m² (sipërfaqe të brendshme 93.51 m²), në vlerën 72,982 euro, e cila parashikohej të likuidohej:

- kësti i parë me vlerë 70,000 euro likuidohet nga porositësi me nënshkrimin e kontratës;
- kësti i dytë dhe i fundit me vlerë 2,982 euro do të likuidohet me dorëzimin e çelësave të apartamentit.

Me deklaratën *Vetting* përcillet edhe kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2014, nga e cila rezultoi se shtetasja M.H³³ ka blerë apartamentin me sipërfaqe totale 104.26 m² në vlerën 72,270 euro, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale sipas kontratës së porosisë.

2.4 Për të vërtetuar faktin e lënies në përdorim të këtij apartamenti nga ana e prindërve të tij, subjekti ka sjellë deklaratën (të thjeshtë) e datës 1.5.2015 të shtetasve M dhe D.H , për lënien e apartamentit për banim djalit të tyre Gentjan Habazaj, në kushtet kur ata kanë një apartament tjetër për të banuar³⁴ dhe pasuri të tjera të paluajtshme.

2.5 ASHK-ja³⁵ nuk ka përcjellë informacion në lidhje me këtë pasuri.

³² Aneks ***, dosja ILDKPKI.

³³ Shihni deklaratën noteriale, ku shtetasi D.H deklaroi se pronësinë mbi apartamentin e kalon në favor të znj. M.H, me të cilën shoqëria “****” sh.p.k. do të lidhë kontratën e shitjes dhe se nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me pronësinë e këtij apartamenti.

³⁴ Prindërit e subjektit kanë porositur prej vitit 2010 apartamentin me çmim blerjeje 101,860 euro dhe prej vitit 2012 kanë banuar në këtë apartament me sip. 101.86 m², me adresë: Njësia Bashkiake Nr. ****, rruga “****”, ***, Tiranë, në të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka jetuar bashkë me prindërit para se të banonte në pasurinë objekt trajtimi.

³⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 8.9.2023.

2.6 FSHU-ja³⁶ dhe UKT-ja³⁷ informojnë se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij nuk ka të regjistruara kontrata për furnizim me energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu, nuk përcillet informacion edhe për prindërit e tij në lidhje me apartamentin në këtë adresë, por nga përgjigjja e UKT-së³⁸ administruar nga dosja e subjektit A.C rezultojnë se shtetasja M.H ka të regjistruar një kontratë furnizimi me nr. ***, me adresë rruga “****”, ***, Tiranë, për të cilën faturimet kanë filluar në qershor të vitit 2015. Gjithashtu, bashkëlidh edhe dokumentet e aplikimit të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., të cilat përfshijnë lejen e ndërtimit, leje legalizimi, kërkesën e shoqërisë për lidhjen e kontratave për furnizim me ujë etj. Ndërsa, FSHU-ja³⁹ informon se identifikohet kontrata nr. ***, me adresë rruga “****”, kabina “****” sh.p.k., me datë lidhjeje 30.6.2015, ku faturimet kanë filluar në qershor të vitit 2015, e lidhur me shtetasja M.H .

2.7 Sipas informacionit⁴⁰ pranë Komisionit për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., ku kjo e fundit sqaroi se sipas kontratës së porosisë si më lart është shlyer shuma prej 72,270 euro pranë BKT-së, nga të cilat 70,000 euro janë shlyer në datën 17.01.2014 dhe 2,270 euro janë shlyer në datën 29.12.2014. Bashkëlidhur përgjigjes së shoqërisë përcillen: mandatpagesa bankare pranë BKT-së; kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2014; kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2014 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2014, midis shtetasve M.H e D.H dhe shoqërisë “****” sh.p.k., ku bien dakord që kontrata përfundimtare të lidhet midis kësaj shoqërie dhe shtetasve M.H .

2.8 Nga komunikimi me BKT-në⁴¹ rezultoi se në datën 17.1.2014 është transferuar shuma 70,000 euro nga llogaria dyemërore e shtetasve D dhe M.H (nr. ***), me përshkrimin “D ose M.H sa kaluar në favor të “****” sh.p.k. për blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë për apartamentin nr. ***, kati *** (****)”. Ndërsa nga kopja e mandatpagesës së BKT-së, të përcjellë me përgjigjen e shoqërisë ndërtuese, Komisioni informohet se pagesa e këstit të fundit është bërë me depozitim *cash* në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në datën 29.12.2014, nga shtetasja M.H , me përshkrimin “Sa derdh për “****” sh.p.k., kësti i fundit për blerje apartamenti ***, sip. 104.26 m² (2+1)”.

2.9 Komisioni hetoi nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës në lidhje me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur procedime penale që kanë lidhje me personat e sipërpërmendur⁴².

³⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 25.9.2023, nga FSHU-ja.

³⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 29.9.2023, nga UKT-ja.

³⁸ Shkresa nr. *** prot., 27.2.2019, nga UKT-ja.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 25.9.2023, nga FSHU-ja.

⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., administruar nga dosja e subjektit A.C.

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2023, nga BKT-ja.

⁴² Shihni shkresat në përgjigje të pyetësorit shtesë drejtuar subjektit të rivlerësimit të Prokurorive Berat, Elbasan, Tiranë dhe Durrës, përkatësisht: nr. ***, datë 6.11.2023; nr. ***, datë 7.11.2023; ***, datë 6.11.2023; nr. ***, datë 7.11.2023 dhe nr. ***, datë 8.11.2023.

2.10 Referuar të dhënave të EKB-së⁴³ rezulton se apartamenti është blerë 1,737,902.7 lekë më shumë se mesatarja e shitjeve, ose 1.2 herë më shtrenjtë⁴⁴ se vlera mesatare e shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë në qytetin e Tiranës në këtë vit.

2.11 Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku parashikohet se *subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur*, subjekti i rivlerësimit është subjekt kontrolli për krijimin e pasurisë në përdorim, apartamenti nr. 93.51 m², blerë në vitin 2014 nga prindërit e tij⁴⁵.

2.12 Ndërsa, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku shprehimisht citohet “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin e justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip. 93.51 m², blerë nga prindërit e tij në vitin 2014.

2.13 Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit⁴⁶ në lidhje me konceptin “persona të tjerë të lidhur”, duke pasur parasysh se prindërit e subjektit nuk kishin mundësi financiare për krijimin e depozitës së kursimit në emër të subjektit, si dhe faktit se apartamenti duket se është krijuar që në fillim ekskluzivisht për përdorim nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vendosi të hetojë kapacitetin financiar të prindërve për krijimin e këtij aseti, apartament banimi, për të verifikuar nëse ka ndonjë rrethanë të pazbuluar apo paraqitje të pasaktë të pasurive në përdorim nga ana e subjektit.

2.14 Sa më sipër, Komisioni analizoi mundësinë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, e cila është në përdorim nga subjekti dhe familja e tij prej vitit 2015 e në vijim.

Në lidhje me mundësitë e blerjes së apartamentit nga babai i subjektit

2.15 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi i pasurisë në trajtim janë kursimet e prindërve.

2.15.1 Nga hetimi i llogarive bankare të prindërve rezulton se shuma 70,000 euro, e transferuar nëpërmjet BKT-së⁴⁷ në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k., është depozituar *cash* nga nëna e subjektit të rivlerësimit në dy data. E para, vlera 12,000 euro në datën 13.1.2014 me përshkrimin “Të ardhura nga puna” dhe vlera 58,000 euro në datën 16.1.2014.

⁴³ Referuar udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2013, pasi kontrata e porosisë është nënshkruar në datën 17.1.2014 dhe udhëzimi i vitit 2014 është në gusht 2014. Çmimi për metër katror në qytetin e Tiranës ka qenë 89,700 lekë/m² për sipërfaqe të shfrytëzueshme ose në vlerë totale 8,387,847 lekë për apartamentin.

⁴⁴ Vlera e shitblerjes së apartamentit me sip. 93.51 m² në qytetin e Tiranës sipas referencave të EKB-së është 8,387,847 lekë, ndërsa nëna e subjektit e ka blerë në vlerën 72,270 euro ose 10,125,750 lekë.

⁴⁵ Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga data 23.11.2009 është shkëputur nga trangu familjar dhe ka jetuar si kryefamiljar/beqar, ndërkohë këtë fakt e ka provuar edhe me certifikatën familjare nga Bashkia Vlorë, datë 7.11.2023, sjellë në përgjigje të pyetësorit shtesë.

⁴⁶ Shihni vendimin nr. 10/2022 të Kolegjit.

⁴⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2023, nga BKT-ja.

2.15.2 Vihet re se në datën 16.1.2014 prindërit e subjektit të rivlerësimit tërheqin shumën 3,013,611.77 lekë⁴⁸ (rreth 21,509 euro) nga llogaria e depozitës së kursimit në monedhën lekë (nr. ***), pranë BKT-së. Kjo depozitë kursimi rezulton të jetë çelur prej tyre në datën 1.11.2002 dhe prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer depozitime dhe tërheqje të herëpashershme në të duke rezultuar me vlerë 15,500,000 lekë deri në datën 26.3.2013. Kjo gjendje duket se krijohet nga transferimi i vlerës së depozitës së çelur më herët⁴⁹ pranë Raiffeisen Bank, ku gjendja e saj në datën 6.3.2013 prej 12,732,400 lekësh është transferuar në llogarinë dyemërore të prindërve (*** - ***), në të cilën janë tërhequr fondet dhe më pas konvertuar dhe ridepozituar në llogarinë e tyre në euro, duke transferuar te shoqëria ndërtuese veprime të kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

2.15.3 Gjithashtu, depozitimi i vlerës së mbetur (për të plotësuar 15,500,000 lekë në datën 26.3.2013) prej 3,349,721.13 lekësh vjen nga tërheqja e shumës 22,082.84 euro (rreth 3,096,235 lekë) në po këtë datë 26.3.2013 e depozitës në euro në llogarinë dyemërore të prindërve (nr. ***). Kjo depozitë është krijuar në datën 20.7.2007 nga depozitimet e prindërve dhe gjendja e saj prej datës 22.10.2008 ka qenë në vlerën 22,225 euro. Ndërsa në datën 16.1.2014 shtetasja M.H tërheq *cash* vlerën e kredisë bankare të marrë pranë BKT-së prej 5,000,000 lekësh (ose rreth 35,686 euro⁵⁰). Kjo kredi më pas shlyhet me fondet e depozitës së kursimit pranë kësaj banke (në datën 6.3.2014).

2.15.4 Duket se vlera prej 58,000 euro e depozituar nga nëna e subjektit për blerjen e apartamentit më 16.1.2014 është krijuar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit nga gjendje *cash* dhe likuiditete në bankë të disponuar prej tyre dhe pjesërisht prej shumës së marrë kredi nga nëna e subjektit pranë BKT-së.

2.16 Komisioni hartoi analizën financiare duke përfshirë të ardhurat e dy prindërve të subjektit nga puna e tyre dhe nga pensionet e pleqërisë, të cilat u konfirmuan nga institucionet, si në vijim trajtuar.

2.17 Nga komunikimi me ISSH-në dhe DPT-në⁵¹ për të ardhurat nga punësimi i prindërve të subjektit rezulton se shtetasja M.H ka përfituar pension pleqërie prej nëntorit 2012 me masë mujore aktuale 29,365 lekë dhe shtetasi D.H rezultonte i punësuar pranë subjektit “D.H”, me NIPT ***, prej janarit 2012 deri në prill 2015 me të ardhura totale neto 706,080 lekë; shtator 2010 – qershor 2017 ka përfituar pension pleqërie me masë mujore përfundimtare 25,449 lekë dhe prej korrikut 2012 – qershor 2017 ka përfituar pension suplementar shtetëror me masë mujore përfundimtare 12,230 lekë.

2.18 Nga vërtetimi⁵² i DRSSH Vlorë, shtetasi D.A⁵³ rezulton të ketë qenë i vetëpunësuar me NIPT *** për periudhën 1.7.2010 – 31.3.2012, ndërsa me vërtetimin⁵⁴ e DRSSH Vlorë, D.A rezulton të jetë i siguruar si person fizik me nr. *** për periudhën 16.2.1999 – 31.12.2014.

⁴⁸ Kursi i këmbimit në BOA (lekë/euro = 140.11).

⁴⁹ Krijimi i saj nis prej vitit 2007 me gjendje 8,000,000 lekë dhe në mars 2010 gjendja e depozitës është 10,000,000 lekë.

⁵⁰ Kursi i këmbimit në BOA (lekë/euro = 140.11).

⁵¹ Shkresa DPT nr. **** prot., datë 6.10.2023, ISSH nr. *** prot., datë 19.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2023.

⁵² Shihni vërtetimin nr. ***, datë 18.10.2016, të DRSSH Vlorë, dosja ILDKPKI.

⁵³ Subjekti ka sjellë vërtetimin nr. ***, datë 26.2.2015 nga Bashkia Vlorë, sipas të cilit D.H është i njëjti person me D.A dhe D.A, dosja ILDKPKI.

⁵⁴ Shihni vërtetimin nr. ****, datë 18.10.2016, të DRSSH Vlorë, dosja ILDKPKI.

2.19 Nga QKB-ja⁵⁵ rezulton se shtetasi D.H ka qenë i regjistruar prej datës 27.3.2003, me NIPT ***, me aktivitetet “aktivitete juridike, avokat”, i cili nga data 27.5.2015 rezulton me status “çregjistruar”.

2.20 DRT Vlorë⁵⁶ informon se shtetasi D.A me NIPT *** është regjistruar me vendim gjykate datë 20.7.1998 dhe se ka shlyer detyrimet tatimore 1999 – 2002 për “tatim biznesi i vogël profesion i lirë” dhe për periudhën 2003 – 2004 ka kryer pagesa për “tatim i thjeshtuar + taksë vendore biznes i vogël”. Gjithashtu rezulton se qarkullimi dhe fitimi i deklaruar për periudhën 2010 – 2015 nga shtetasi D.H ka qenë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi (lekë)
2010	440,000	155,158
2011	171,200	37,087
2012	45,600	-11,127
2013	31,500	-26,982
2014	0	-51,256
2015	99,167	1,626
Totali	787,467	104,506

2.21 Analiza financiare për burimin e krijimit të apartamentit është hartuar duke filluar nga viti 2010, pasi rezultoi nga analiza financiare e trajtuar më sipër në çështjen nr. 1 se deri në fund të vitit 2009 rezultati financiar është me vlerë negative (-2,872,511 lekë). Pra, prindërit e subjektit deri në vitin 2009 nuk kanë pasur mundësi të kursejnë të ardhura të ligjshme, të cilat mund të shërbenin si burim për blerjen e apartamentit.

2.22 Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se gjatë periudhës kohore 2010 – 2013 prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer edhe investime të tjera si më poshtë:

- prindërit e subjektit gjatë viteve 2010 – 2012 kanë investuar në blerjen edhe të 3 pasurive të tjera, të cilat në vlerë totale kanë qenë në shumën 253,860 euro;
- po ashtu, prindërit e subjektit të rivlerësimit gjatë kësaj periudhe kanë rritur likuiditetet e tyre në sistemin bankar, të cilat përlllogariten në shumën totale 26,649,435 lekë;
- rezultoi nga dosja e administruar e subjektit A. C. se në këtë kohë (viti 2011) është bërë edhe dhurimi i shumës 42,000 euro nga prindërit e subjektit, dhëndrit të tyre me burim të deklaruar kursime familjare.

2.23 Ndërsa gjatë periudhës 2010 – 2012, të ardhurat e prindërve të subjektit janë raportuar në vlerën 3,701,026 lekë⁵⁷, të cilat duket se janë të pamjaftueshme për të mbuluar vlerat e investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera prej tyre, në krijimin e likuiditeteve në sistemin bankar dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në këtë periudhë. Pra, nëse do të konsiderohen në analizën e Komisionit edhe konstatimet sa më lart për periudhën 2010 – 2012, për prindërit e subjektit, atëherë të ardhurat e disponueshme për t’u përfshirë në analizën financiare të krijimit të apartamentit do të ishin vetëm rezultati i vitit 2013, të cilat janë në vlerën 985,114 lekë. Këto rezultojnë të jenë të pamjaftueshme për të përballuar pagesat për apartamentin dhe shpenzimet e jetesës në këtë vit.

⁵⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 18.9.2023, nga QKB-ja.

⁵⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 17.10.2023.

⁵⁷ Duke konsideruar se të ardhurat e tyre të periudhës kanë shërbyer edhe për të mbuluar vlerat e humbjeve të rezultuara nga aktiviteti i avokatisë i babait të subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me kredinë e marrë nga banka në shumën 5.000.000 lekë në vitin 2014

2.24 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e banesës ka deklaruar: “Unë jetoj në një apartament, në adresën: Tiranë, rruga “****”, h. ***, ap. ***, pasuria nr. ***, sip. 93.51 m², blerë nga prindërit e mi, me kursimet e tyre, më 17.1.2014. Prindërit e mi ma kanë dhënë në përdorim”. Për sa më sipër, subjekti nuk përmend në këtë deklaratë si burim të banesës kredinë në shumën 5,000,000 lekë, të disbursuar dhe tërhequr në datën 16.1.2014, ditën kur janë depozituar 58,000 euro në llogarinë e nënës për pagesën e apartamentit. Gjithashtu, në kontratën e kredisë nuk kishte asnjë specifikim për destinacionin e kredisë, e cila ishte siguruar me *cash* kolateral nga depozita e kursimit me vlerë 10,000,000 lekë.

Vlen të theksohet se kredia është dhënë duke vendosur si kolateral një depozitë kursimi⁵⁸ në shumën 10,000,000 lekë, e cila pasi është maturuar është përdorur për shlyerjen e plotë të kësaj kredie në datën 6.3.2014. Prandaj, duket se qëllimi i vërtetë i kredisë është marrë për të mos humbur interesin e depozitës, por burimi real dhe thelbësor i shumës 5,000,000 lekë (përdorur për blerjen e apartamentit) nuk është vetë kredia, por depozita që ka shlyer kredinë vetëm 2 muaj më vonë nga data e disbursimit të saj. Në lidhje me burimin ligjor të depozitës nuk provohet ligjshmëria e krijimit të saj, duke iu referuar analizës financiare të hartuar ndër vite.

2.25 Duke marrë parasysh arsyetimet e mësipërme, analiza e apartamentit do të hartohet duke konsideruar si burim të ligjshëm vetëm vlerën e kursimeve të vitit 2013, në shumën 730,048 lekë (shihni tabelën më poshtë), e cila është e pamundur të mbulojë vlerën e pagesës së apartamentit në shumën e konvertuar 10,125,749.7 lekë. Pra, pamundësia financiare do të rezultonte në shumën -9,422,683.7 lekë.

2.26 Komisioni, pasi konstatoi sa më lart, hartoi analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë, duke u mbështetur në vendimmarrjen e deritanishme dhe në qëndrimet e konsoliduara të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit⁵⁹, në të cilat orientohet Komisioni: “Kolegji⁶⁰ çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur”. Më poshtë është paraqitur analiza financiare e prindërve të subjektit duke përfshirë vetëm të ardhurat dhe shpenzimet jetike të periudhës.

Vitet	2010	2011	2012	2013	Analiza financiare kumulative 2010 - 31.12.2013
TË ARDHURAT	815,303 lekë	2,255,184 lekë	641,666 lekë	1,012,096 lekë	3,224,249 lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit	340,285 lekë	356,264 lekë	378,768 lekë	452,148 lekë	1,527,465 lekë
Të ardhura nga paga e babait të subjektit të rivlerësimit sipas ISSH			204,168 lekë	207,568 lekë	411,736 lekë
Të ardhura nga paga e nënës e subjektit të rivlerësimit pranë RBAL	319,860 lekë	361,833 lekë			681,693 lekë

⁵⁸ Nr. llogarie ***.

⁵⁹ Vendim nr. 2/2023 (JR), datë 2.2.2023; subjekti i rivlerësimit E. T. vendim nr. 1/2023 (JR) datë 17.1.2023; subjekti i rivlerësimit A. C; etj.

⁶⁰ Vendim nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019, subjekti i rivlerësimit D. Rr.

Të ardhura nga aktiviteti i avokatisë së babait të subjektit të rivlerësimit	155,158 lekë	37,087 lekë			192,245 lekë
Të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit të rivlerësimit			58,730 lekë	352,380 lekë	411,110 lekë
SHPENZIMET	273,240 lekë	273,240 lekë	279,096 lekë	282,048 Lekë	1,107,624 lekë
Shpenzime jetike	273,240 lekë	273,240 lekë	279,096 Lekë	282,048 Lekë	1,107,624 lekë
Rezultati financiar	542,063 lekë	1,981,944 lekë	362,570 lekë	730,048 lekë	2,116,625 lekë

2.27 Rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën 2,116,625 lekë gjatë periudhës 2010 – 2013. Gjithashtu, nga hetimi duket se kredia e marrë pranë BKT-së në vitin 2014 me vlerë 5,000,000 lekë ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me vlerë totale 72,270 euro ose rreth 10,125,750⁶¹ lekë.

Sa më lart, në përfundim të hetimit rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kishin mundësi financiare për të blerë me të ardhura të ligjshme apartamentin pranë shoqërisë “****” sh.p.k., duke rezultuar me pamundësi në vlerën 3,009,125 lekë⁶².

2.28 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i kaloi barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

2.29 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: “Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka vendosur të më lërë barrën e provës në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament, duke rezultuar me pamundësi nga prindërit e mi në vlerën -3,000,125 lekë. Neni 52 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “Nëse Komisioni arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Në rezultatet e hetimit, faqe 13, Komisioni është shprehur: Komisioni, pasi konstatoi sa më lart, hartoi analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë, duke u mbështetur në vendimmarrjen e deritanishme dhe qëndrimet e konsoliduara të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në të cilat orientohet Komisioni “Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur”.

Prindërit e mi, i ndjeri ati im D.H (i cili ka ndërruar jetë në vitin 2017) dhe nëna ime M.H nuk janë “persona të lidhur” në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, sepse nuk kemi qenë në të njëjtin trung familjar (siç ka rezultuar nga certifikata familjare datë 7.11.2023), në të cilën pasqyrohet se Gentjan Habazaj është kryefamiljar vetëm, dhe beqar, dhe nuk janë as persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016. Apartamenti i blerë prej prindërve të mi, i cili është në pronësi të nënës sime, znj. M.H, në pjesën 100%, më është lënë vetëm në përdorim për të banuar me familjen time dhe nuk kam asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri”.

⁶¹ BOA exchange rate mesatare për vitin 2014 euro/all = 140.11

⁶² Vlera e apartamentit 10,125,750 lekë – 5,000,000 lekë vlera e kredisë – 2,116,625 lekë vlera e kursimeve të mundshme.

2.30 Lidhur me pagesat, nëpërmjet dokumentit bankar ato janë kryer duke u kredituar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., pranë BKT-së: kësti i parë në datën 17.1.2014, shuma 70,000 euro; kësti i dytë në datën 29.12.2014 në vlerën 2,270 euro.

Krijimi i shumës së pagesës së këstit të parë në vlerën 70,000 euro janë:

- shuma 12,000 euro (kredituar në datën 13.1.2014);
- shuma 32,000 euro (kredituar në datën 16.1.2014);
- shuma 26,000 euro (kredituar në datën 16.1.2014).

2.31 Subjekti, gjithashtu, shpjegoi se prindërit e tij kanë zotëruar pranë BKT-së depozitën dyemërore me nr. **** në lekë, D ose M.H , e cila është çelur më 1.11.2002, kohë kur subjekti i rivlerësimi ka qenë student në vitin e parë në universitet, ndërkohë që është emëruar prokuror në stazh pas 7 vjetësh, me Dekretin nr. ***, datë 12.10.2009, të Presidentit të Republikës dhe 8 vjet para emërimit si prokuror me Dekretin nr. ***, datë 2.11.2010.

2.32 Gjithashtu, zanafilla e depozitës për të cilën është lënë barra e provës është më e hershme. Nëna M.H ka zotëruar pranë ish-Bankës së Kursimeve depozitë kursimi. Po ashtu, si rezultojnë edhe nga dokumentacioni i administruar nga bankat, vihet re se origjina e depozitës është që nga viti 1997 me vlerë fillestare 1,300,00 lekë, ndërsa vlera e saj në vitin 2006 arrin shumën 7,000,000 lekë, e transferuar kjo në Alpha Bank dhe e rikthyer në Raiffeisen Bank në depozitën nr. ***, çelur në datën 2.3.2007, në emër të nënës M.H . Referuar kësaj kronologjie të krijimit të kësaj depozite, më 2.3.2007 prindërit e subjektit kanë disponuar shumën 8,000,000 lekë.

2.33 Nga viti 2007 deri në shtator 2009, përveç depozitimit të parë (8,000,000 lekë), në këtë llogari është depozituar edhe shuma 282,544 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga puna dhe kursimet familjare, si dhe janë përfituar të ardhura nga interesat në shumën 943,463 lekë.

Totali i akumuluar në depozitë deri në shtator 2009, para marrjes së detyrës është në vlerën 9,200,000 lekë. Sipas trajtimit të kryer në analizën financiare për këtë periudhë, prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj depozite.

2.34 Për periudhën 2010 – 2013, në depozitën pranë Raiffeisen Bank janë kredituar *cash* 794,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga puna dhe kursimet familjare, si dhe janë përfituar të ardhura nga interesat në shumën 2,740,473 lekë.

2.34.1 Totali i akumuluar në depozitë deri më 6.3.2013 është në vlerën 12,732,400 lekë.

2.34.2 Sa më sipër, në depozitën e llogarisë nr. *** pranë Raiffeisen Bank deri në datën 6.3.2013 janë depozituar në total 9,076,544 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga puna dhe kursimet familjare, si dhe janë përfituar të ardhura nga interesat në shumën 3,683,936 lekë.

2.34.3 Në total, deri në datën 6.3.2013 shuma në llogari ishte 12,732,400 lekë. Kjo shumë transferohet në datën 6.3.2013, në llogarinë nr. ***, në BKT, në monedhën lekë. Në po këtë datë lidhet kontratë depozitë bankare me nr. *** ndërmjet palëve D dhe M.H dhe BKT për shumën 12,800,000 lekë.

2.34.4 Referuar analizës kronologjike të historikut të krijimit të depozitës bankare, rezultojnë se pjesë e burimit të krijimit të saj janë dhe të ardhurat nga interesat e përfituar nga kjo depozitë në vite, për të cilat është paguar edhe tatimi përkatës. Totali i interesave të përfituar nga depozita për periudhën 2010 – 2013 është në shumën 2,828,312 lekë⁶³.

⁶³ Shuma 2,828.312 = interesa 2010 – 2013 Raiffeisen Bank (571.320 + 720.000 + 714.753 + 734.400) + interesa viti 2013 BKT (74.227 + 13.612).

2.35 Subjekti kërkoi nga Komisioni që kjo shumë e të ardhurave nga interesat të përfshihet në analizën financiare të prindërve të tij për vitet 2010 – 2013, si dhe pjesa e papërfshirë në analizën e Komisionit e kursimeve kumulative për periudhën deri në vitin 2009, të cilat rezultojnë me një balancë pozitive +2,504,395 lekë, si dhe vlerën e kredituar në llogarinë bankare të prindërve të subjektit pranë BKT-së, në datën 13.3.2012, në vlerën 822,700 lekë me përshkrimin “P. Fizik kalim për M.H për ekzekutim vendimi”, që sipas sqarimit të nënës janë pagat e gjyqit të fituar kundër *** për largim nga puna. Nga analiza financiare për periudhën 2010 – 2013, duke përfshirë kursimet kumulative për periudhën deri në vitin 2009, të ardhurat nga interesat, si dhe përfitimin e nënës nga “P. Fizik kalim për M.H për ekzekutim vendimi” rezultojnë sipas subjektit se prindërit e tij kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën 8,272,032 lekë.

2.36 Lidhur me huamarrjen subjekti ka parashtruar: *“Prindërit e mi kanë zotëruar në BKT depozitën dyemërore nr. ***, e cila është hapur në datën 1.11.2002. Në momentin kohor të kësaj vendimmarrjeje (blerjen e apartamentit), prindërit e mi dispononin dy depozita bankare pranë BKT-së, konkretisht në vlerat 10,000,000 lekë dhe 2,000,000 lekë, me datë depozite 6.3.2013. Rezultojnë se në këtë datë, ndërmjet palëve D dhe M.H dhe BKT-së është lidhur kontratë për shumën 12,800,000 lekë, me normë vjetore 6.21%. Sipas kësaj kontrate shuma e interesit është 794,880 lekë. Referuar statementit bankar konfirmohet se shuma 12,800,000 lekë ka qenë e ndarë në dy pjesë (depozita) 10,000,000 lekë dhe 2,000,000 lekë, me afat 1-vjeçar, me datë maturimi 6.3.2014.*

*Në kushtet kur duhej kryer pagesa prej 70,000 euro dhe për të mos prishur interesat që rrjedhin nga depozitat e sipërcituara, prindërit vendosën të marrin kredi nga banka. Në datën 14.1.2014 është lidhur kontratë bankare ndërmjet kredithënës Banka Kombëtare Tregtare dhe kredimarrës znj. M.H për marrjen e një kredie në shumën 5,087,000 lekë. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 19.1.2024, është disbursuar kredia me peng depozite në datën 14.1.2014 me vlerë 5,087,000 lekë me datë maturimi 6.3.2014. Sipas këtij vërtetimi rezultojnë se kredimarrja, e cila është me afat maturimi deri në datën 6.3.2014 është marrë vetëm me qëllimin për të financuar pagesën e këstit të parë të apartamentit, por në momentin e maturimit të depozitës kredia do të shlyhej. Kostoja e kredimarrjes në total ishte 50,940,65 lekë. Sa më sipër, kostoja e pagesës prej 50,940,65 lekësh ka qenë dukshëm më e vogël sesa përfitimi që do të rezultonte sipas interesave nga maturimi i depozitave prej 12,800,000 lekësh”.*

2.37 Ndërsa në lidhje me vlerën 3,000,000 lekë të dhënë hua nga prindërit shtetasit A. C., kjo çështje është trajtuar në shkronjën “e” të pikës 1 të këtij vendimi, ku subjekti ka kërkuar vlerësimin e mundësisë së babait të tij për krijimin e shumës 3,000,000 lekë deri në vitin 2003 dhe shtimin si e ardhur e prindërve të tij për periudhën 1994 – shtator 2011.

2.38 Komisioni trajtoi edhe çështjen në lidhje me trashëgiminë, dëshminë e trashëgimlënësit D.H , datë 30.10.2023 (i cili ka ndërruar jetë në vitin 2017). Për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor, Komisioni nuk kishte dijeni në lidhje me trajtimin e pasurive të babait të tij pas vdekjes. Subjekti deri në parashtrimet përfundimtare nuk kishte sjellë informacion në lidhje me këtë fakt. Bashkëlidhur parashtrimeve subjekti vuri në dispozicion një kopje të procesverbalit të çeljes së testamentit të trashëgimlënësit, babait të subjektit, z. D.H , i cili i ka lënë trashëgimi subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj dy pasuri, të cilat përbëjnë një banesë të vetme në Vlorë, ndërsa apartamenti ku banon aktualisht subjekti i është lënë nënës së tij, i cili ndodhet në pronësi të saj.

2.39 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se prindërit e subjektit kanë rezultuar me mundësi për blerjen e apartamentit në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, pasi konsideroi faktet e provat si vijon:

- Vlerat e interesave të depozitës së kursimit kanë qenë më të larta se interesi i kredisë, e konfirmuar kjo nga përgjigjet e BKT-së⁶⁴, interesi i kredisë ishte 50,940 lekë (për periudhën 2-mujore) dhe interesi i depozitës së kursimit ishte në total 707,840 lekë.

- U provua me dokumentacionin bankar (statement) të BKT-së dhe Raiffeisen Bank të ardhurat e nënës nga *** (ekzekutimi i vendimit të gjykatës), si dhe shpërndarja nga *** e të ardhurave si ortakë.

- U përfshinë në analizën financiare të ardhurat nga depozitat bankare të prindërve për periudhën 2010 – 2013 pranë RBAL dhe BKT-së. Vlerat e shpjeguara nga subjekti në prapësime përputhen me *statementin* bankar të bankave të përcjella në Komision.

2.40 Më poshtë është paraqitur analiza financiare e prindërve të subjektit për periudhën 2010 – 2013 duke bërë përditësimet e saj sipas konkluzioneve me lart sqaruar, duke u përfshirë edhe kredia bankare prej 5,000,000 lekësh dhe rezultati financiar i analizës për periudhën 1994 – shtator 2009.

Vitet	2010	2011	2012	2013	Analiza financiare kumulative 2010-31.12.2013
Të ARDHURAT	1,386,623 Lekë	1,553,632 Lekë	2,179,119 Lekë	1,834,335 Lekë	6,953,709 Lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit	340,285 Lekë	356,264 Lekë	378,768 Lekë	452,148 Lekë	1,527,465 Lekë
Të ardhura nga paga e babait të subjektit të rivlerësimit sipas ISSH			204,168 Lekë	207,568 Lekë	411,736 Lekë
Të ardhura nga paga e nënës e subjektit të rivlerësimit pranë RBAL	319,860 Lekë	361,833 Lekë			681,693 Lekë
Të ardhura nga aktiviteti i avokatisë të babait të subjektit të rivlerësimit	155,158 Lekë	37,087 Lekë			192,245 Lekë
Të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit të rivlerësimit			58,730 Lekë	352,380 Lekë	411,110 Lekë
Të ardhurat të nënës së subjektit nga *** transfertë bankare RBAL për ortakët e saj		78,448 Lekë			78,448 Lekë
Të ardhurat të nënës së subjektit nga *** transfertë bankare BKT me vendim gjykate			822,700 Lekë		822,700 Lekë
Të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit pranë RBAL	571,320 Lekë	720,000 Lekë	714,753 Lekë	734,400 Lekë	2,740,473 Lekë
Të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit pranë BKT				87,839 Lekë	87,839 Lekë
SHPENZIMET	273,240 Lekë	273,240 Lekë	279,096 Lekë	282,048 Lekë	1,107,624 Lekë
Shpenzime jetike	273,240 Lekë	273,240 Lekë	279,096 Lekë	282,048 Lekë	1,107,624 Lekë
Rezultati financiar	1,113,383 Lekë	1,280,392 Lekë	1,900,023 Lekë	1,552,287 Lekë	5,846,085 Lekë
Vlera e rezultatit financiar të analizës së periudhës 1994-shtator 2009 të prindërve					1,067,952 Lekë
Kredia bankare pranë BKT me vlerë 5,000,000 lekë					5,000,000 Lekë
Vlera totale e burimeve të mundshme për blerjen e apartamentit					11,914,037 Lekë

⁶⁴ Subjekti bashkëlidh kontratë depozitë bankare me nr. referencë ***.

3. Automjet tip “****”, blerë në vitin 2013

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “****”, në shumën 100,000 lekë. Aktualisht me targë AA ***.

Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, me targë VL ***, ndryshuar targat në AA ***, i cili është shitur në datën 16.1.2013, në shumën 300,000 lekë, blerë para fillimit të funksionit si prokuror dhe nga kursimet e prindërve”*.

Hetimi i Komisionit

3.1 DPSHTRR-ja⁶⁵ ka konfirmuar se shtetasi Gentjan Habazaj ka në pronësi automjetin me targë AA ***. Sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2013, rezultoi se z. Gentjan Habazaj i ka blerë automjetin tip “****”, në vlerën 100,000 lekë shtetasit I.H, i cili duket se e ka zhdoganuar këtë automjet në doganën e Durrësit më 26.2.2013, pasi e ka blerë në shtetin italian me vlerë 700 euro.

3.2 Ndërsa me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2023, të DPSHTRR-së, konfirmon se subjekti ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA *** (të cilin e ka mbajtur deri në datën 28.7.2017). Subjekti e deklaroi në DIPP-në e vitit 2017 shitjen e automjetit në vlerën 100,000 lekë.

3.3 Referuar deklaratimit të burimit të blerjes së automjetit tip “****”, subjekti ka listuar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “****”, blerë në vitin 2009, sipas faturës tatimore⁶⁶ të shitjes nr. ***, datë 19.7.2009, ku z. Gentjan Habazaj blen automjetin në shumën 257,438 lekë. Këtë automjet tip “****”, me targë AA *** subjekti e ka shitur në vitin 2013, në vlerën 300,000 lekë sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2013.

3.4 Komisioni hetoi mbi mundësinë financiare për të blerë automjetin në vitin 2009. Në deklaratën e parafillimit të detyrës subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë tip “****”, me targë VL ***, blerë në datën 19.7.2009, me faturë tatimore në vlerën 257,348 lekë”*. I pyetur nga ILDKPKI-ja⁶⁷ në lidhje me burimin e blerjes së automjetit në vitin 2009, subjekti ka deklaruar se: *“Ky aset më është dhuruar nga prindërit e mi dhe si burim kanë shërbyer kursimet shumëvjeçare nga punët e tyre në sektorin privat. Dua të theksoj se babai punon si avokat prej 12 vjetësh”*.

3.5 Duket se automjeti tip “****” është blerë nga para marrjes së detyrës.

3.6 Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit duket se edhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit para marrjes së detyrës, të cilat siç u konfirmuan nga shkresat e institucioneve në shumën totale 1,004,115 lekë, janë të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri⁶⁸.

3.7 Në lidhje me burimin e krijimit për automjetin tip “****”, me targë AA ***, subjekti deklaroi në DIPP-në e vitit 2013 shitjen e automjetit tip “****”, datë 16.1.02013: *“Shtuar gjendja cash në shtëpi në shumën 300,000 lekë nga të ardhurat personale dhe shitja e*

⁶⁵ Shihni shkresat e DPSHTRR nr. *** prot., datë 17.7.2017, datë 8.8.2017 dhe datë 3.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresa nr. *** prot., datë 25.9.2023 në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, përcjellë nga subjekti i rivlerësimit.

⁶⁷ Shihni kopje të procesverbaleve të ILDKPKI-së, datë 29.9.2010, bashkëlidhur shkresës së ILDKPKI-së me lëndë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.7.2023.

⁶⁸ Të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës në total janë 1,004,115 lekë, të cilave pasi u zbriten shpenzimet jetike për dy vite, likuiditetet në bankë, rezultati del 595,741 lekë.

*automjetit tip “***”*. Gjithashtu, ai deklaroi në DIPP-në e vitit 2013 edhe blerjen e automjetit tip “***”, më 16.3.2013, dy muaj pas shitjes, si vijon: “Në datën 16.1.2013 është shitur automjeti tip “***” në shumën 300,000 lekë”.

3.8 Nuk u konstatua që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në konflikt interesi⁶⁹ me shtetasin I. H, në cilësinë e shitësit të automjetit tip “***”, blerë nga subjekti në vitin 2013.

Në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri për procesin e rivlerësimit.

4. Llogari bankare në BKT

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar⁷⁰ llogari rrjedhëse të pagës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, në BKT, hapur më 13.5.2014. Vlera: 637 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i Komisionit

4.1 BKT-ja⁷¹ ka konfirmuar se në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, 23.1.2017, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 637.07 lekë. Kjo llogari page është çelur nga subjekti i rivlerësimit në datën 2.6.2014 dhe në të janë transferuar pagat e tij prej kësaj date nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

4.2 Gjithashtu, subjekti, përpara hapjes së llogarisë së pagës pranë BKT-së, rezultoi se ka pasur llogari pranë Raiffeisen⁷² Bank, e cila është çelur në datën 31.10.2007. Në këtë llogari janë transferuar bursat e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së ndjekjes së Shkollës së Magjistraturës, paga pranë Prokurorisë së Rrethit Durrës dhe më pas paga në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat deri në prill 2014.

4.3 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* të ardhurat:

- bursë studimi nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2007 – 2009, shuma 1,004,115 lekë;
- të ardhurat nga paga si kandidat/prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën tetor 2009 – dhjetor 2010, në shumën 856,423 lekë;
- të ardhurat nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për periudhën nëntor 2010 – dhjetor 2016, në shumën 5,754,319 lekë.

4.4 Me deklaratën *Vetting* subjekti përcjell⁷³ vërtetime nga institucionet në lidhje me të ardhurat e deklaruara:

- Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e konfirmuara nga ISSH-ja⁷⁴ dhe DPT-ja⁷⁵ dhe për periudhën përpara janarit 2012 ka përfshirë në analizë të ardhurat e konfirmuara nga vërtetimet e institucioneve, të cilat janë përcjellë nga subjekti me deklaratën *Vetting*, por edhe sipas vlerave të transferuara në llogaritë bankare të tij.

4.5 Në tabelën më poshtë janë pasqyruar vlerat e të ardhurave të përfshira në analizën financiare nga Komisioni.

⁶⁹ Shihni shkresën me lëndë kthim përgjigje të Prokurorisë së Rrethit Berat, nr. ***, datë 6.11.2023.

⁷⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016, nga BKT-ja, sipas të cilit Gentjan Habazaj ka pasur llogari depozite me afat hapur më 13.6.2003.

⁷¹ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2023, nga BKT-ja.

⁷² Shkresa nr. *** prot., datë 18.9.2023, nga RBAL.

⁷³ Aneks *** dosja ILDKPKI.

⁷⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 19.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2023, nga ISSH-ja.

⁷⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2023, nga DPT-ja.

Viti	Para detyrës	Tetor - Dhjetor 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Totali
Të ardhura nga bursa e studimit nga Shkolla e Magjistraturës nga viti 2007-2009	1,004,115									1,004,115
Të ardhura nga paga si kandidat/Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe si Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.		162,248	820,935	912,530	837,854	769,330	1,013,952	982,326	1,037,390	6,536,565
TOTALI	1,004,115	162,248	820,935	912,530	837,854	769,330	1,013,952	982,326	1,037,390	7,540,680

4.6 Subjekti i rivlerësimit deklaron në total vlerën 6,610,742 lekë nga paga si prokuror për periudhën tetor 2009 – 2016, e cila rezulton në një diferencë prej 74,177 lekësh më shumë me vlerën e përfshirë në analizën e Komisionit, për shkak të mospërfshirjes së shumave të dietave në llogaritjet e Komisionit.

Sa më lart, nuk u konstatuan problematika për procesin e rivlerësimit.

5. Bashkëshortja e subjektit deklaron në deklaratën e pasurisë: “Llogari depozite në Raiffeisen Bank nr. ***. Hapur në datën 14.1.2011, përpara se të martohesha⁷⁶ me subjektin e deklaramit. Vlera: 213,831 lekë⁷⁷. Burim krijimi: dhuruar nga prindërit”.

5.1 Bashkëshortja bën të njëjtin deklaram për këtë llogari në DIPP-në e vitit 2013, i cili është deklarami i saj i parë si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pas lidhjes së martesës me të.

5.2 Raiffeisen Bank⁷⁸ konfirmon se në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë datë 23.1.2017 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 213,831.43 lekë, ndërsa llogaria është hapur në datën 14.1.2011 nga depozitimi *cash* i vlerës 200,000 lekë. Në datën 12.11.2012, bashkëshortja e subjektit derdh në llogari vlerën 300,000 lekë, e cila pjesërisht tërhiqet prej saj gjatë periudhës gusht - shtator 2013 dhe më pas gjendja e saj mbetet e pandryshuar deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

5.3 Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes së llogarisë bankare, bashkëshortja deklaron se vlera i është dhuruar nga prindërit para martesës me subjektin e rivlerësimit. Sa shpjeguar gjatë procesit të rivlerësimit, martesë është lidhur në datën 27.9.2013, ndërsa vlerat e depozituara *cash* janë kryer në vitin 2011 dhe 2012.

5.4 ISSH-ja⁷⁹ dhe DPT-ja⁸⁰ informojnë se prindërit e bashkëshortes, znj. A.Dh prej majit 2021 përfiton pension pleqërie në masën 17,243 lekë dhe z. N.Dh prej korrikut 2016 deri në tetor 2016 ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “***” me pagë neto mujore 27,910 lekë; për periudhën qershor 2009 – dhjetor 2018 ka përfituar pension suplementar ushtarak të parakohshëm me masë mujore përfundimtare 15,629 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit bashkëlidh me deklaratën *Vetting*⁸¹.

⁷⁶ Subjekti deklaron në pyetësorin standard se ka lidhur martesë ligjore në datën 27.9.2013.

⁷⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. ***, datë 9.1.2017, nga RFB-ja për llogari në shumën 213,831 lekë. Aneks nr***, dosja ILDKPKI.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, nga RBAL.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2023, nga ISSH-ja.

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2023, nga DPT-ja.

⁸¹ Aneks nr***, dosja ILDKPKI.

5.5 Komisioni hartoi analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit si vijon:

Analiza financiare kumulative 2003 – 1.11.2012	
TË ARDHURAT	3,517,200 lekë
Të ardhura nga pensioni i babait të bashkëshortes	867,148 lekë
Të ardhura nga paga e babait të bashkëshortes, transferuar pranë bankës RBAL dhe vërtetim i DRSSH	2,207,542 lekë
Të ardhura nga paga e nënës së bashkëshortes, transferuar pranë bankës RBAL	442,510 lekë
SHPENZIMET	2,412,864 lekë
Shpenzime jetike për 2 anëtarë	2,412,864 lekë
REZULTATI FINANCIAR	1,104,336 lekë

5.6 Sa më lart, duket se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi për të dhuruar vlerën 200,000 lekë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit përpara lidhjes së martesës ligjore me të.

Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë⁸² të ardhurat nga:

- Paga si pedagoge në U.A. T nga data 23.10.2012 (përpara lidhjes së martesës me subjektin më 27.9.2013) deri më 31.5.2014. Pagesa kryhej në llogarinë rrjedhëse të pagës si pedagoge pranë U.A.T, Fibank, nr. ***. Ky universitet nuk vazhdon më aktivitetin sepse është mbyllur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 6.8.2014, pika 11/11. Shuma 123,499 lekë para martesë + 342,335 lekë pas martesë = në total 465,834 lekë.

- Leje lindje, filluar më 2.6.2014 deri më 1.6.2015. Tërheqja e parave kryhej *cash* në monedhën lekë pranë Postës Shqiptare, arka nr. ***, Tiranë. Shuma: 279,972 lekë.

- Ushtrimi i profesionit të stomatologes për periudhën 1.12.2016 – 23.1.2017 në K.D.T, D, fshati T, rruga “****”, objekt privat nr. ***, kati ***, me NUIS ***; dhjetor 2016 në shumën 11,250 lekë + janar 2017 në shumën 2,500 lekë; në total 13,750 lekë.

5.7 Fibank⁸³ informon se bashkëshortja e tij ka hapur llogari në datën 26.11.2012 dhe në këtë llogari transferoheshin të ardhurat nga paga e saj në U.A.T.

5.8 QKB-ja⁸⁴ informon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është regjistruar si person fizik në datën 1.12.2016, me NIPT ***, dhe aktivitet “klinikë dentare”. Aktualisht statusi i saj është “çregjistruar prej datës 12.9.2017”.

5.9 ISSH-ja⁸⁵ dhe DPT-ja⁸⁶ informojnë se shtetasja E.H për periudhën tetor 2012 – gusht 2014 ka qenë e punësuar pranë U.A.T, ndërsa DPT-ja konfirmon se personi fizik “E.H” me aktivitet

⁸² Subjekti i bashkëlidhur deklaratës: kopje e librezës së punës së E.Dh, lëshuar nga U.A.T, datë 23.10.2012; kopje e Fletores Zyrtare nr. 123, datë 7.8.2014, ku është botuar vendimi nr. 539, datë 6.8.2014 për mbylljen e institucionit privat të arsimit të lartë “Sh.L.A.T”; vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga DRSSH Berat, sipas të cilit N.Dh është pensionist dhe përfiton aktualisht pension suplementar sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, në masën 14.858 lekë/muaj, me datë fillimi pensioni 8.6.2009, totali i të ardhurave nga data 8.6.2009 – 21.10.2016 është 1,964,608 lekë. Bashkëlidhur pasqyra përmbledhëse e të ardhurave; vërtetim nga Fibank nr. ***, datë 10.1.2017; statement bankar datë 10.1.2017 ku figuron kreditimi i pagave për periudhën 2012 – 2014 në shumën 476,182 lekë; vërtetim nr. *** datë 18.10.2016 nga DRSSH Tiranë, sipas të cilit E.Dh është paguar me raport barrëlindje për periudhën 2.6.2014 – 1.6.2015 në shumën 279.972 lekë; certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm E.H, person fizik, datë 1.12.2016, me adresë Tiranë, D, T, rruga “****”, objekt privat nr. ***, kati ***.

⁸³ Shkresa nr. *** prot., datë 21.9.2023, nga Fibank.

⁸⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 18.9.2023, nga QKB-ja.

⁸⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2023, nga ISSH-ja.

⁸⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2023, nga DPT-ja.

“klinikë dentare” gjatë vitit 2016 ka deklaruar *qarkullim në vlerën 11,250 lekë dhe humbje në vlerën 107,159 lekë.*

5.10 Komisioni ka përfshirë në analizën e tij të ardhurat sa paraqitur në tabelën e mëposhtme, të cilat janë konfirmuar nga ISSH-ja, DPT-ja, si dhe konfirmuar edhe me transfertat në llogarinë e bashkëshortes pranë Fibank⁸⁷, ndërsa në lidhje me aktivitetin dentar të bashkëshortes nuk janë përfshirë të ardhura, pasi rezultoi me humbje në vitin 2016.

Viti	2013	2014	2015	Totali
Të ardhura të bashkëshortes pranë UAT	255,312 lekë	87,023 lekë		342,335 lekë
Të ardhura nga leje lindja		191,396 lekë	88,576 lekë	279,972 lekë

Sa më lart, nuk u konstatuan problematika për procesin e rivlerësimit.

GJETJE TË TJERA

6. Në lidhje me adresat e deklaruara të subjektit

6.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar dy adresa, njëren adresë ku banon – rruga “****”, pallati “****”, shkalla ***, ap. ***, tek **** Tiranë dhe adresa ku është regjistruar në gjendjen civile – Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, ***, Tiranë.

6.2 Këto dy adresa përkojnë me vendbanimin e subjektit në Tiranë, përkatësisht në vitet 2013 – 2015 në adresën: Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, ***, Tiranë dhe nga viti 2015 e në vazhdim në adresën: rruga “****”, pallati “****”, shkalla ***, ap. ***, Tiranë, dhe me deklaratimet në DPV-të e viteve 2013 – 2016. Këto apartamente-pasuri janë në pronësi të prindërve të subjektit.

6.3 Ndërsa, lidhur me adresat e banimit për periudhën 2009 – 2013, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe emërimit si prokuror në stazh, në periudhën 12.10.2009 – 25.11.2009 subjekti ka jetuar në vendin e tij të lindjes, Vlorë, adresa: rruga “****”, lagjja “****”⁸⁸. Në muajin nëntor 2009 ka jetuar në lagjen “****”, tek ****, në Tiranë.

6.4 Në periudhën dhjetor 2009 – shtator 2010 subjekti ka jetuar në Durrës⁸⁹, në Lagjen nr. ***, pranë shkollës së mesme “****”. Në vitet 2010 – 2013 ka jetuar përsëri në banesën e prindërve në Vlorë.

6.5 Nuk u konstatua që subjekti i rivlerësimit të këtë qenë në konflikt interesi⁹⁰ me qiradhënësin (P. M dhe vëllain e tij R. M) përgjatë viteve 2009 – 2010, në Durrës.

7. Në lidhje me adresën ku ka jetuar për periudhën 2013 – maj 2015 dhe ku ka të regjistruar gjendjen civile *Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, ***, Tiranë*, në përgjigjen e ASHK-së të dosjes së A. C të administruar rezultojnë **dy apartamente të blera** në këtë adresë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit:

a) Apartament me sip. 91.19 m², nr. ****, është blerë me kontratën e shitjes nr. ****, datë 28.1.2016, me palë blerëse M dhe D.H nga shoqëria “****” sh.p.k., me çmim shitjeje 101,860 euro, në të cilën parashikohet se vlera është shlyer sipas kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, bashkëlidhet edhe kontrata e sipërmarrjes me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 12.4.2010, lidhur

⁸⁷ Shkresa nr. **** prot., datë 21.9.2023, nga Fibank.

⁸⁸ Subjekti ka sqaruar se emërtimi i rrugës ka ndryshuar disa herë (nga S.Z në P.B etj.). E njëjta problematikë është hasur edhe më parë nga Komisioni në një çështje tjetër.

⁸⁹ Si provë subjekti ka sjellë deklaratë noteriale nr. **** kol., datë 17.7.2020, të vëllait të pronarit të shtëpisë.

⁹⁰ Shihni shkresën me lëndë *Kthim përgjigje* nr. ****, datë 7.11.2023, të Prokurorisë së Rrethit Durrës.

midis porositesit D.H dhe shoqërisë “****” sh.p.k., ku parashikohet se çmimi i blerjes (1,000 euro/m²) do të shlyhet:

- kësti i parë – 25,000 euro likuidohet me nënshkrimin e kontratës;
- kësti i dytë – prej 10,000 euro do të likuidohet deri në korrik 2010;
- kësti i tretë – 20,000 euro do të likuidohet në tetor 2010;
- kësti i fundit – diferenca e mbetur prej 46,860 euro do të likuidohet deri më 15.3.2011.

b) Apartament me sip. 112 m², nr. pasurie *, hyrja ***, ap. ***, me adresë rruga “****”, Tiranë, rezulton se është blerë me kontratën nr. ***, datë 28.1.2016, nga prindërit e subjektit të rivlerësimit nga shoqëria “****” sh.p.k. me çmim shitjeje 125,000 euro, i cili është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.4.2010. Përcillet kopje e kontratës së sipërmarrjes, e cila është lidhur midis shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe shtetasit D.H për blerjen e apartamentit me sip. 125 m², me çmim total 125,000 euro dhe mënyra e shlyerjes së tij është:**

- kësti i parë – 25,000 euro likuidohet me nënshkrimin e kontratës;
- kësti i dytë – 10,000 euro do të likuidohet deri në korrik 2010;
- kësti i tretë – 20,000 euro do të likuidohet në tetor 2010;
- kësti i fundit – diferenca e mbetur prej 70,000 euro do të likuidohet deri më 15.3.2011.

7.1 Nga përgjigjja e UKT-së⁹¹, administruar nga dosja e subjektit A.C, rezulton se znj. M.H ka lidhur 2 kontrata furnizimi me ujë me UKT-në, kontrata të tipit familjar, me nr. *** dhe nr. *** për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, bashkëlidhur me përgjigjen edhe kopja e certifikatave të pronësisë dhe dokumente të identifikimit të znj. M.H . Këto kontrata janë lidhur për dy apartamentet e regjistruara në vitin 2016 në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit⁹², ndërsa FSHU-ja identifikon abonentin M.H , me kontratë furnizimi nr. ***, në adresën rruga “****”, kabina ***, me datë lidhje kontrate 23.11.2011, ku faturimet kanë filluar nga qershori 2012 (sipas informacionit të SMI bashkëlidhur shkresës).

7.2 Komisioni (nga dosja e administruar) i është drejtuar edhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., e cila përcjell kopje të kontratave të shitjes së dy apartamenteve, si më lart, dhe informon mbi mënyrën e shlyerjes së çmimit të blerjes për secilin apartament duke e shoqëruar me kopje të mandatpagesave dhe mandateve bankare. Pagesat e detajuara janë si vijon:

- a) Apartament me sip. 91.19 m² me çmim 101,860 euro
 - mandatpagesë nr. ***, datë 17.7.2010, vlera 20,000 euro;
 - mandatpagesë nr. ***, datë 5.4.2011, vlera 50,000 euro;
 - mandatpagesë ***, datë 5.3.2012, vlera 20,000 euro;
 - transfertë bankare pranë BKT-së, datë 26.12.2012, vlera 10,850 euro;
 - mandatpagesë nr. ***, datë 16.1.2012, vlera 1,008 euro.
- b) Apartament me sip. 112 m² me çmim 125,000 euro
 - mandatpagesë nr. ***, datë 12.4.2010, vlera 50,000 euro;
 - mandatpagesë nr. ***, datë 9.10.2010, vlera 40,000 euro;
 - mandatpagesë nr. ***, datë 30.4.2011, vlera 25,000 euro;
 - mandatpagesë nr. ***, datë 27.1.2016, vlera 706 euro;

⁹¹ Shkresa UKT nr. *** prot., 27.2.2019.

⁹² Përkatesisht për pasurinë apartament me sip. 91.19 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, adresë rruga “****”, hyrja ***, ap. ***; pasuria e dytë, apartament me sip. 112 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, adresë rr. “****”, hyrja ***, ap. ***. UKT informon se kontrata me nr. *** në emër të z. D.H ka filluar faturimet nga shkurti 2011.

- pagesë bankare pranë Union Bank datë 27.1.2016, vlera 9,294 euro.

7.3 BKT-ja⁹³ dhe Union Bank i konfirmojnë transaksionet e mësipërme të kryera në llogaritë e tyre.

7.4 Në lidhje me burimin e pagesave të apartamenteve nga hetimi i llogarive bankare të prindërve të subjektit për vitet 2010 – 2016, rezultoi se ata nuk kanë pasur mundësi të kursejnë vlerat e blerjes së apartamenteve me të ardhura të ligjshme. Por, pas shpjegimeve e provave në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi krijimi të ardhurash me burime të ligjshme për shtimin e pasurive të tyre.

8. ASHK⁹⁴ Vlorë informon se në vitin 2015 shtetasi D.H ka blerë një apartament tjetër në shumën 27,000 euro. Ky apartament me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 47.48 m², në O, Vlorë, është blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.6.2015, nga pala shitëse shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k., me palë blerëse D.H me çmim blerjeje 27,000 euro.

8.1 Çmimi i blerjes në kontratën e shitblerjes ka qenë i parashikuar të shlyhet pranë shoqërisë “***” sh.p.k., si vijon:

- kësti i parë prej 3,000 euro është likuiduar me mandatin datë 12.9.2010;
- kësti i dytë prej 7,000 euro është likuiduar me mandatin datë 9.10.2010;
- kësti i tretë prej 5,000 euro është likuiduar me mandatin datë 15.1.2011;
- kësti i katër prej 5,000 euro është likuiduar me mandatin datë 28.5.2011;
- kësti i pestë prej 5,000 euro është likuiduar me mandatin datë 13.7.2011;
- kësti i gjashtë dhe i fundit prej 2,000 euro është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës, në llogarinë e noterit pranë Credins Bank.

8.2 Bashkëlidhur përgjigjes së ASHK Vlorë përcillen kopjet e mandatpagesave të kryera nga babai i subjektit të rivlerësimit.

9. ASHK⁹⁵ Vlorë informon gjithashtu se shtetasi D.H ka plotësuar formular vetëdeklarimi për lejen e legalizimit në datën 24.5.2005 për shtesë pallati, në apartamentin me sip. 74.7 m², në pallatin nr. ***, në bashkëpronësi të shtetasve D dhe M.H ⁹⁶. Sipas procesverbalit të konstatimit datë 8.8.2009, numri i kateve mbi tokë është 5 dhe në këtë deklaram për legalizim përfshihen 10 bashkëpronarë. Leja e legalizimit rezulton për objektin *shtesë anësore banimi dhe shërbimi 5 kate në objekt ekzistues 5 kate*. Ndërsa kontrata e kalimit të pronësisë e parcelës ndërtimore është nënshkruar në datën 18.6.2013 me prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarët e tjerë, me drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë, në bazë të VKM-së Nr. 345, datë 24.4.2013.

Sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ndjekur studimet gjatë vetëdeklarimit dhe para marrjes së detyrës kur është kryer akt konstatimi.

⁹³ Shkresa BKT nr. *** prot., datë 3.10.2023 dhe Shkresa Union Bank nr. *** prot., datë 3.10.2023.

⁹⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 9.10.2023.

⁹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 9.10.2023.

⁹⁶ Pasuri e përfutur me kontratë dhurimi nr. *** rep., datë 20.6.1995 nga shtetaset: B.A (nëna e D H), D.A (motra e D. H) dhe M.A (e bija e D. A).

10. ASHK Tiranë⁹⁷ informon se subjekti i rivlerësimit ka blerë garazh me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2018 nga shoqëria “****” sh.p.k., me sip. 27.3 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, me vendndodhje në rrugën “****”, Tiranë. Sipas kontratës, çmimi i blerjes së tij është 860,000 lekë, i cili është shlyer nëpërmjet llogarisë së noteres pranë Raiffeisen Bank. Përcillet me shkresë kopja e kartelës së pasurisë.

10.1 Subjekti deklaron në DIPP-në e vitit 2018 si burim të krijimit të kësaj pasurie pjesërisht fondet e depozitës së kursimit me vlerë totale 4,800,000 lekë, pranë Raiffeisen Bank, e cila është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe është trajtuar në pikën 2.

Sa më lart, nuk u konstatuan problematika për procesin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri.

11. Në lidhje me emrin e subjektit (G dhe G)

11.1 Në lidhje me gjeneralitetet e subjektit të deklaruara në formularin e deklarimit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur emrin G, ndërsa tani mban emrin G.

11.2 Komisioni ka hetuar në lidhje me kohën e mbajtjes së këtij mbiemri nëpërmjet këqyrjes së të dhënave nga regjistri i gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është mbajtur i emrit Gentjan përpara kohës së ushtrimit të detyrës si prokuror. Emri G ka qenë emri i gjyshit të subjektit të rivlerësimit (D.G.H).

Sa më lart, nuk u konstatuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit.

12. Analiza financiare tetor 2009 – 2016

Metodologjia e kryerjes së analizës financiare – Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

13. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare – Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

13.1 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë neto lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁹⁸, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

⁹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 8.9.2023, nga ASHK-ja.

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2023, e ISSH-së dhe nr. *** prot., datë 25.9.2023; shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2023, e DPT-së; vërtetimet e institucioneve punëdhënëse të përcjella me deklaratën *Vetting* në aneksin nr. ***.

13.2 Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes, për të cilët është bërë trajtimi i shpenzimeve jetike në bazë të deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile.

13.3 Pra, prej marrjes së detyrës tetor 2009 deri në gusht 2013, shpenzimet jetike janë llogaritur si familje me 1 anëtar, pasi subjekti rezultoi i vetëm në certifikatën e gjendjes civile dhe në pyetësorin standard deklaroi se shpenzimet e tij i ka mbuluar vetë, edhe pse ka jetuar në banesën në pronësi të prindërve. Ndërsa nga shtatori i vitit 2013 deri në qershor 2014 janë llogaritur me 2 anëtarë, pas lidhjes së martesës ligjore me personin e lidhur, shtetasen E.H. Prej korrikut të vitit 2014, pas lindjes së djalit të subjektit të rivlerësimit, llogaritjet janë bërë me 3 anëtarë deri në dhjetor 2016.

13.4 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe deklaramit e subjektit⁹⁹. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaramit e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu janë konsideruar vetëm shpenzimet minimale 5 euro si shpenzime ditore dhe nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit, për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklaramin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaramit e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Për udhëtimet ditore, vajtje-ardhje brenda ditës, janë konsideruar vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe 5 euro si shpenzime ditore.

13.5 Shpenzimet për blerje automjesh¹⁰⁰ u bazuan në deklaramit vjetore të subjektit, pyetësorët, si dhe në dokumentacionin përkatës. Gjithashtu janë përfshirë në analizën financiare shpenzime qiraje sipas deklaramiteve të subjektit dhe bashkëshortes në deklaramita periodike dhe në deklaramitën *Vetting*, përkatësisht në vitet 2009 – 2010 dhe 2016.

13.6 Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaramit e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaramita e interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe gjendjet e likuiditeteve¹⁰¹ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

13.7 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikua dhe u krahasua përputhshmëria e deklaramiteve të subjektit të rivlerësimit në deklaramita e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaramitën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

13.8 Në konkludim të sa më sipër, analiza financiare për periudhën tetor 2009 – 2016 rezultoi me vlerë pozitive¹⁰². Ndërsa analiza përpara fillimit të detyrës rezultoi me pamundësi financiare në vlerën - 2,699,775 lekë, për të cilën Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për pamundësinë financiare të rezultuar.

13.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me pamundësinë financiare prej -2,699,775 lekësh përpara fillimit të detyrës, duke arritur në konkluzionin se prindërit e subjektit kishin mundësi financiare për krijimin e pasurive të tyre, duke zbritur shpenzimet e jetesës.

⁹⁹ Përgjigjet e pyetësorit standard.

¹⁰⁰ Shihni shkresat e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 17.7.2017, datë 8.8.2017 dhe datë 3.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2023, në dosjen e Komisionit.

¹⁰¹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2023, e BKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, e Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2023, e Fibank.

¹⁰² Vlera 3,560,581 lekë.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

14. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare tetor 2009 – 2016

Përshkrimi	Tetor - Dhjetor 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	(7,627)	377,303	179,193	(58,906)	1,261,183	169,245	(1,000,910)	(785,820)
Autoveturë ***, në shumën 100,000 lekë. Aktualisht me targa ***. Burimi i blerjes nga shitja e automjetit *** me targa ***, ndryshuar targat në ***, i cili është shitur në datë 16.1.2013 në shumën 300,000 lekë, blerë para fillimit të funksionit si Prokuror, nga kursimet e prindërve.					100,000			
Banoj në apartamentin me adresë ***, Rruga "****" hyrja *, ap. *, nr. Pasurie *** me sip. 93.51 m2, blerë nga prindërit nga kursimet e tyre më dt. 17.01.2014. Ky apartament më është dhënë në përdorim nga prindërit. Vlera 72,270 euro. Pjesa takuese 100%.								
Autoveturë *** me targa ***, blerë më datë 19.7.2009 me faturë tatimore 257,348 lekë, i cili është shitur në datë 16.1.2013 në shumën 300,000 lekë, blerë para fillimit të funksionit si Prokuror, nga kursimet e prindërve.					(257,348)			
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	-7,627	377,303	179,193	-58,906	1,418,531	169,245	-1,000,910	-785,820
Total likuiditete	5,425,690	5,802,993	5,982,185	5,923,279	7,341,810	7,511,055	6,510,146	5,724,326
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	(7,627)	377,303	179,193	(58,906)	1,261,183	169,245	(1,000,910)	(785,820)
TË ARDHURA të dokumentuara	162,248	820,935	914,079	838,556	2,024,642	1,292,371	1,070,902	1,037,390
Bursë studimi nga Shkolla e Magjistraturës nga viti 2007-2009. Shuma 1,004,115 lekë.								
Të ardhura nga paga si kandidat/Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe si Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.	162,248	820,935	912,530	837,854	769,330	1,013,952	982,326	1,037,390
Të ardhura nga paga e bashkëshortes nga mësimdhënia tek UAT nga tetor 2012 deri ditën e celebrimit 27.9.2013 dhe të dhëna nga prindërit e saj si kontribut për martesën pajë. Nga paga e b/shortes 123,499 lekë dhe nga prindërit 876,501 lekë, në total 1,000,000 lekë.					1,000,000			
Të ardhura nga paga e bashkëshortes nga mësimdhënia tek UAT pas martesë deri në dt. 31.5.2014 në shumën 342,972 lekë.					255,312	87,023		
Të ardhura nga leje lindje e bashkëshortes, filluar më dt.2.6.2014 deri më dt. 1.6.2015. Tërheqja e parave kryhej në cash në monedhën lekë pranë Posta Shqiptare, arka nr. *, Tiranë. Shuma 279,972 lekë.						191,396	88,576	
Të ardhura nga bashkëshortja nga ushtrimi i profesionit të stomatologes nga data 1.12.2016-23.1.2017. Dhjetor 2016 në shumën 11,250 lekë + janar 2017 në shumën 2,500 lekë; në total 13,750 lekë.								
Të ardhura nga depozita e kursimit			1,549	702				
SHPENZIME	41,155	282,906	289,563	252,306	309,762	549,995	1,672,828	1,068,365
Shpenzime qiraje për klinikën dentare të bashkëshortes me vlerë 25,000 lekë/muaj								25,000
Shpenzime qiraje deklaruar në pyetësor nr. 1	7,000	63,000						
Shpenzime mobilimi dhe arredimi							1,000,000	
Shpenzime udhëtimi	-	83,286	152,943	112,758	133,482	-	-	338,089
Shpenzime jetike	34,155	136,620	136,620	139,548	176,280	549,995	672,828	705,276
Analiza dokumentuar	128,720	160,726	445,323	645,156	453,697	573,131	398,984	754,844

B. KONTROLLI I FIGURËS

15. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

15.1 Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin¹⁰³ për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj.

15.2 Në vijim, pas kërkesës¹⁰⁴ së Komisionit drejtuar AKSIK-së për përditësimin e raportit të vitit 2017, është përcjellë njoftimi për raportin e kontrollit të figurës të deklasifikuar plotësisht¹⁰⁵ për subjektin e rivlerësimit Gentjan Habazaj, me të njëjtin konkluzion si në raportin e vitit 2017, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

15.3 Komisionit nuk i kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* të tjera për këtë subjekt rivlerësimi.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

16. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për subjektin Gentjan Habazaj nuk u gjetën elemente, që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit sipas informacionit¹⁰⁶ nga sistemi TIMS. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

17. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit lidhur me: aftësitë profesionale; aftësitë organizative; etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

18. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Prokurorisë së Përgjithshme e prokurorive të rretheve gjyqësore etj.

19. Për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, z. Gentjan Habazaj ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe aktualisht është komanduar dhe ushtron detyrën e këshilltarit ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

¹⁰³ Shihni raportin dërguar nga AKSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2017.

¹⁰⁴ Shihni kërkesën nr. *** prot., datë 12.7.2023, të Komisionit drejtuar AKSIK-së.

¹⁰⁵ Shihni raportin e deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.10.2023, të KDZH-së.

¹⁰⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.9.2023, të DPPSH-së.

20. Nga të dhënat statistikore për periudhën e rivlerësimit, prokurori Gentjan Habazaj ka trajtuar gjithsej 754 çështje (procedime dhe kallëzime), nga të cilat 233 mosfillime, 131 të pushuara, 264 dërguar gjyqit, 123 të pezulluara dhe tri akte të dorëzuara nga subjekti.

➤ **Pas verifikimit dhe shqyrtimit të 4 dokumenteve të paraqitura nga subjekti dhe 5 çështjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.**

21. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve, Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, rezultoi që ndaj subjektit Gentjan Habazaj:

- nuk janë dhënë masa disiplinore;
- nuk janë depozituar ankesa.

DENONCIME

22. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 18 denoncime. Disa nga denoncimet janë të përsëritura dhe gjithsej rezultojnë 9 denoncime të trajtuara për subjektin Gentjan Habazaj.

22.1 Denoncim i përsëritur i shtetasit H.Sh nr. * prot., datë 15.1.2021, nr. *** prot., datë 5.11.2021, nr. *** prot., datë 10.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.5.2022**

Ky shtetas ka paraqitur denoncimin e tij para shumë institucioneve të larta shtetërore, duke përfshirë edhe Komisionin. Ai ankohet për punën e organit të Prokurorisë, konkretisht për disa prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore në lidhje me një kallëzim penal të vitit 2017 për disa titullarë të ish-Komunës P.

Arsyet se përse zvarritet hetimi ndaj ish-kryetarit të Komunës P sipas ankuesit është fakti se ai përvetëson dhe dhunon pronën e tij, pa kryer procedurat e shpronësimit, duke cenuar pronën dhe interesin e saj ligjor. Vendimi i KRRT-së për prishje të ish-Komunës P nr. ***, datë 11.4.2008, për realizimin e projektit “Sheshi i pazarit të P”, nuk ka përcaktuar se çfarë do të priset nga prona e tij, sa dhe si do të cenohet ajo, duke lënë kështu hapësirë për abuzim. Gjithashtu, ankuesi ka kallëzuar ish-kryetarin e Komunës P edhe për abuzimet në lidhje me pronat e përfituara nga ligji nr. 7501 i vitit 1991, me AMTP-në përkatëse, duke ua dhënë shtetasve të tjerë, të cilëve nuk u takonte me ligj, sipas përcaktimeve të neneve 248, 186/3 dhe 134 të Kodit Penal. Në listën e personave të kallëzuar janë edhe ish-punonjës të institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë dhe shtetas të tjerë. Edhe ILD-ja ka konstatuar mosplotësim kriteresh pranimi në ankesat e vazhdueshme të shtetasit H. Sh drejtuar këtij institucioni.

Në përfundim, pavarësisht listimit të emrit të subjektit të rivlerësimit në ankesat e tij, ankuesi nuk sjell pretendime konkrete në lidhje me problematikat e caktuara në adresë të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, këto ankesa janë pa objekt në drejtim të hetimit tonë.

22.2 Denoncim nr. * prot., datë 18.7.2019, i shtetasit A.Ç**

Ky denoncim ka ardhur nga Institucioni i Komisionerëve Publikë. Shtetasi A. Ç. është ankuar për shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Gentjan Habazaj.

Kallëzimet dhe ankesat e tij pranë SHÇBA-së janë të drejtuara kundër stafit mësimor të shkollës ku mëson fëmija i tij, si dhe ndaj shumë punonjësve të Policisë së Shtetit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Disa prokurorë të tjerë, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, pas kryerjes së hetimeve të nevojshme kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këto kallëzime, për shkak se nuk është vërtetuar ekzistenca e elementeve të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

Sipas kallëzimit të shtetasit A. Ç. në lidhje me dokumentin, vendim i datës 22.11.2018 për mosfillimin e procedimit penal i subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi asnjë shkelje procedurale të mundshme, ku mund të hetohej më tej.

22.3 Denoncim nr. * prot., datë 9.10.2018, i shtetases M. B**

Kjo shtetase ka denoncuar edhe më parë subjekte të tjera pranë Komisionit në lidhje me çështjen e pronës së saj dhe trashëgimtarëve të tjerë të familjes. Në këtë denoncim ajo ankohet ndaj gjyqtarës K. C. dhe subjektit të rivlerësimit, duke thënë se gjyqtarja ka shkelur procedurën penale duke pranuar raportin e prokurorit nëpërmjet *email*-it vetëm pak minuta para se të fillonte seanca gjyqësore, duke marrë vendim për shtyrjen e seancës gjyqësore. Nga materiali denoncues, denoncuesja liston vendime gjykatash, por edhe gjyqe që janë në proces. Në denoncimin e datës 9.10.2018, denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes e ka dërguar çështjen për kompetencë në SPAK¹⁰⁷, e ka kthyer¹⁰⁸ materialin sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me arsyetimin se nuk ka kryerje të veprës penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Denoncuesja pretendon se Prokuroria e Rrethit Berat e hodhi poshtë denoncimin e tyre për korrupsion, shpërdorim detyre me pasoja të rënda në dëmtimin e pronës (duke lejuar subjektin “T. E.” sh.p.k. të vazhdojë të punojë në mënyrë joligjore). Duket se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2019, referuar konstatimeve të SPAK-ut.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me arsyen e dërgimit për kompetencë pranë SPAK-ut të procedimit penal të sipërcituar dhe arsyet që kanë çuar subjektin të vendosë më pas mosfillimin e këtij procedimi penal të kthyer.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: “*M. B dhe A. Q janë dy shtetase që për të njëjtin fakt, problem pronësie, kanë bërë kallëzime penale të vazhdueshme, duke u ankuar ndaj vendimmarrjeve të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019 të këtyre shtetaseve, nga ana ime në datën 20.1.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në vendim arsyetohet se... denoncimi për shtetasin E. L. për veprat penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, bazuar në nenin 75/a dhe nenin 84 të Kodit të Procedurës Penale, janë kompetencë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2020, ia kemi dërguar për kompetencë kësaj Prokurorie. Me shkresën nr. *** prot., K. B., datë 15.1.2020, kjo Prokurori e ka kthyer materialin sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me arsyetimin se nuk kemi kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal dhe nuk konstatohen elemente të ndonjë veprë tjetër penale. Në bazë të neneve 89 dhe 28, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, kur ka mosmarrëveshje për kompetencë, Prokuroria e Shkallës së Parë është e detyruar të pranojë zgjidhjen që i ka dhënë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë. Në rastin e kallëzimit të M. B., kjo Prokurori nuk ka konstatuar ndonjë vepër tjetër penale, për të cilën të orientonte hetimin. Proceduralisht duhej që vetë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të vendoste mosfillim të procedimit penal, por për shkak se materialin ia ktheu Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i negej Prokurorisë së Rrethit Berat të vendoste për mosfillimin e procedimit penal, ku dhe kam vendosur mosfillimin e procedimit penal brenda afatit 15-ditor, të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Në datën 26.5.2021 jam transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nuk ishte më përgjegjësi e imja ndjekja e këtij procedimi, i cili është regjistruar me nr. ***, datë 31.1.2023, nga një prokuror tjetër, për shkak të vendimit të Gjykatës së Apelit për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga*

¹⁰⁷ Denoncuesja referon shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2020.

¹⁰⁸ Denoncuesja referon shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2020.

neni 150 i Kodit Penal, veprë penale e ndryshme nga pretendimi i kallëzimit. Ky procedim penal është në fazë hetimi dhe ndiqet nga prokurorë të tjerë”.

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura për ankesën e datës 9.10.2018 nga subjekti i rivlerësimit ishin të mjaftueshme dhe bindëse.

22.4 Denoncim i përsëritur i shtetasve H dhe L.B nr. * prot., datë 29.5.2019, nr. *** prot., datë 29.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 29.5.2019**

Këta shtetas kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj: shtetas M. Sh., notere; shoqërisë “***”; punonjësve të ALUIZNI-t dhe atyre të ZVRPP-së për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Mashtrimi” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186, 143, 248 dhe 25 të Kodit Penal. Ky kallëzim është paraqitur më 11.4.2019, ndërsa në datën 29.5.2019 denoncuesit kanë paraqitur ankim pranë Komisionit me lëndë “Kërkohet verifikueshmëria e figurës dhe anës profesionale e z.G.Habazaj, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Këtë ankim denoncuesit e lidhin me faktin se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes ka shqyrtuar kallëzimin penal ndaj shtetasve M. Sh. (notere) dhe A. Sh. (administrator i shoqërisë “***”) për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Mashtrimi” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim, të cilët sipas denoncuesve këta shtetas, duke falsifikuar dokumentin deklarativ noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2015, me të cilin u kanë sjellë një dëm shumë të madh, pasi autorët e saj, noteri së bashku me ndërtuesin, nëpërmjet mashtrimit/shpërdorimit të besimit, si dhe falsifikimit të dokumenteve, kanë arritur të tjetërsojnë pronën e tyre tek të tretë (pasuri me sip. 169 m² dhe 153 m²), të cilat sipas ekspertit llogariten përkatësisht në vlerat 126,000 euro dhe 39,000 euro. Këtë dokument pretendohet se shtetasit M. Sh. dhe A. Sh. jo vetëm e kanë falsifikuar, por edhe e kanë përdorur para institucioneve ZVRPP Tiranë dhe ALUIZNI Tiranë dhe prokurori, sipas denoncuesve në ndjekjen e procedimit penal, nuk ka marrë parasysh aktekspertimin e paraqitur nga ata dhe nuk ka kryer asnjë aktekspertim (ekzaminim nënshkrimesh) për të vërtetuar nëse qëndrojnë pretendimet e tyre sipas rezultateve të arritura nga aktekspertimi nr. ***, datë 20.9.2017, i depozituar nga kallëzuesit (kopje e të cilit gjendet bashkëlidhur këtij ankimi).

Referuar vendimit të datës 7.5.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal” të subjektit të rivlerësimit, i cili gjendet bashkëlidhur dokumentacionit të denoncuesve, vihet re se subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes ka thirrur dhe pyetur kallëzuesit, të cilët kanë dëshmuar se të kallëzuarit kanë falsifikuar një deklaratë noteriale të vitit 2015, nga e cila kallëzuesit përjashtohen nga përfitimi edhe i dy pasurive të tjera (garazhet dhe papafingo), në kuadër të marrëveshjes për përfitimin e disa pasurive (40%) nga ndërtimi i një pallati 7-katësh nga shoqëria nën administrim nga shtetasi A. Sh. Këto pasuri të paluajtshme ankuesit do t’i përfitonin si pronarë të truallit, ku do ndërtohej pallati 7-katësh. Kallëzuesit kanë pretenduar se deklarata noteriale është e falsifikuar, që do të thotë se ata nuk e kanë nënshkruar një deklaratë të tillë dhe gjithashtu kanë sjellë edhe aktin e ekspertimit të cituar më lart, nga ku vërtetohet se nënshkrimet e tyre ishin falsifikuar. I pyetur edhe ndërtuesi A. Sh., ndër të tjera ka deklaruar se shtetasit H. dhe L. B kanë nënshkruar në zyrën e noteres bashkë me të. Gjithashtu, në lidhje me aktin e ekspertimit të kryer nga kallëzuesit, ai ka pretenduar se ai akt është i kundërshtueshëm, meqë është bazuar mbi dokumente fotokopje.

Prokurori ka vlerësuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, por kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje juridiko-civile, duke i orientuar palët të ngrenë padi në gjykatën civile, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. ***, viti 2019.

Konstatime të Komisionit

Siç shihet nga arsyetimi i këtij vendimi mosfillimi, prokurori pranon faktin e dokumentit deklarativ noterial datë 14.5.2018, si dhe aktekspertimit të kryer nga eksperti në lidhje me

ligjshmërinë e kësaj deklarate, si dokument i diskutueshëm dhe i kundërshtueshëm nga palët, por nuk urdhëron kryerjen e veprimeve hetimore për nxjerrjen e një konkluzioni bazuar në prova shkencore, siç mund të ishte urdhërimi i kryerjes së aktekspertimit të deklaratës objekt kallëzimi penal, duke qenë se sipas aktekspertimit të sjellë nga kallëzuesit ka rezultuar se firmat e ankuesve/kallëzuesve janë falsifikuar.

Ndërsa, paragrafi i fundit i vendimit të mosfillimit nga ana e prokurorit përmban shprehje konfuze dhe të paqarta në lidhje me konkluzionin e tij përfundimtar.

Duket se prokurori nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në drejtim të kryerjes së veprimeve procedurale, me qëllim hetimin sipas këtij procedimi penal. E parë kjo në vështrim të pikës 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prokurori në vendimin e tij ka qenë i paqartë dhe jo i kuptueshëm në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik.

Lidhur me këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime, si dhe informacion për statusin aktual të kësaj çështjeje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se nga praktika kjo ankesë është shqyrtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë¹⁰⁹, i cili ka vendosur arkivimin e saj. Më tej, subjekti ka sqaruar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur kallëzim penal nga shtetasit H. B. dhe L. B., bashkëshortë me njëri-tjetrin. Kallëzimi penal është bërë kundër shtetasve M. Sh., notere dhe A. Sh., administrator i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., për veprat penale “Falsifikimi dokumenteve”, “Mashtrimi” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186, 143 dhe 248 dhe 25 të Kodit Penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, pretendimet e ankuesve se prokurori Gentjan Habazaj nuk ka vepruar kundër të kallëzuarve, të cilët kanë raporte me njerëz të gjyqësorit, nuk është aspak i vërtetë, pasi ai deklaroi se nuk i ka njohur kallëzimet H. B. dhe L. B. dhe as të kallëzuarit M. Sh. dhe A. Sh. Gjithashtu, sipas subjektit, pretendimi se nuk janë kryer veprime hetimore për të verifikuar kallëzimin penal nuk është i vërtetë. Pasi kallëzimi penal i është shortuar me shortin e datës 18.4.2019, ia ka deleguar dosjen oficerit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë që të kryejë veprime verifikuese. E konkretisht, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore, në datën 26.4.2019 u është marrë deklarim shtetasve H. B. dhe L. B.; në datën 2.5.2019 i është marrë deklarim shtetasve M. Sh., si dhe është mbajtur procesverbal për këqyrjen e dokumenteve të dorëzuara nga M. Sh.; në datën 3.5.2019 i është marrë deklarim shtetasit A. Sh., si dhe është mbajtur procesverbal për këqyrjen e dokumenteve të dorëzuara nga shtetasi Dh. K.

Pasi janë kryer veprimet e mësipërme, është konkluduar me vendimin e datës 7.5.2019, me të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2019.

Në vendimin e mosfillimit janë paraqitur deklaratimet e të gjithë shtetasve në mënyrë transparente, vendimi u është njoftuar kallëzimitarëve dhe të kallëzuarve. Vendimi është i arsyetuar, duke u cituar një pjesë e tij: “...bëhet fjalë për një akt ekspertimi të paraqitur në gjykatë, i cili është kryer me dokumente fotokopje dhe jo me origjinal. Kallëzimetarët kanë ngritur padi civile në gjykatë, e cila është rrëzuar nga gjykata... fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale dhe kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje juridiko-civile”.

Nga fashikulli rezulton se kallëzuesit kanë bërë aktin e ekspertimit privat nr. ***, datë 20.9.2017, me cilësinë e objektit të ekspertimit “Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2015”. Ky akt ekspertim nuk është kryer nga Instituti i Policisë Shkencore dhe nuk mund të kryhet akt ekspertimi mbi një fotokopje, e cila nuk ka cilësinë e dokumentit. Në kriminalistikë ekziston procedura që për të kryer një ekspertim të nënshkrimeve të personave, duhet që krahasimi të bëhet midis modeleve të lira apo modeleve eksperimentale me objektin e ekspertimit dhe objekti i ekspertimit të jetë nënshkruar nga një person fizik, i cili lë gjurmë

¹⁰⁹ Subjekti citoi shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2023 dhe vendimin nr. ***, datë 19.4.2023, të ILD-së.

me mjetin e shkrimit (laps, stilolaps etj). Në rastin konkret, objekti i ekspertimit, nënshkrimi në deklaratën noteriale fotokopje nuk përmbush kushtin e gjurmës së lënë nga një qenie humane, por është gjurmë e një makinerie shtypshkrimi, në rastin konkret fotokopje, dhe nuk mund të merret si objekt ekspertimi. Ky aktekspertim nuk është marrë parasysh dhe nuk përmbush as kushtet e një *indicieje* për të kryer veprime të tjera hetimore. Ndërsa në lidhje me fjalinë “mund të ngrihet vetëm me padi në gjykatën civile” është një gabim material në tekst, i cili mund të ketë mbetur nga arsyetimi i një vendimi të mëparshëm dhe pa të teksti do të ishte: *“Kallëzimet kanë ngritur padi civile në gjykatë e cila është rrëzuar nga gjykata. Për sa më lart, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje juridiko-civile”*.

*“Në datën 27.9.2019 më është ndërprerë komandimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe është vendosur rikthimi im në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Nga shkresa nr. *** prot., datë 16.1.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se vendimmarrja ime është ende në fuqi, sepse materiali kallëzues vazhdon me status mosfillim procedimi penal”*.

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti ishin të plota dhe të qarta.

22.5 Denoncim nr. * prot., datë 3.7.2020, i shtetasit B.M**

Ky shtetas i është drejtuar Komisionit me denoncimin ndaj gjyqtarit P. Z., si dhe subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi sqaron se në datën 7.2.2020 janë paraqitur para Komisarariatit të Policisë Skrapar në praninë e OPGJ-së, z. H. M., për të paditur shtetasin E. S. për “Pushim cenimi të posedimit të pronës dhe zaptimit të saj me dhunë”, të fituar me ligjin nr. 7501, pasi kanë marrë vesh nga të afërmit e tyre në lidhje me cenimin e pronës së tyre.

Prokurori G. Habazaj, i cili ka shqyrtuar çështjen në fjalë, ka vendosur mosfillimin e hetimit. Pala kallëzuese ka bërë ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit në datën 29.2.2020. Janë lajmëruar për zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 29.6.2020, ku data e gjyqit do të ishte 2.7.2020. Denoncuesi dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij, pjesëmarrës në gjyq, ankohen për mungesën e etikës së treguar nga ana e gjyqtarit të çështjes dhe, për këtë arsye, ata kanë kërkuar përjashtimin e tij. Denoncuesi sjell pjesë nga regjistrimi i seancës audio me gjyqtarin, duke fokusuar denoncimin e tij tek fjalori arrogant dhe joprofesional i gjyqtarit.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këto pretendime të denoncuesit, si dhe iu kërkua të sqarojë në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje pas ushtrimit të së drejtës së ankimit nga pala kallëzuese.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Për sa i përket ankesës së shtetasit B. M, ajo rezulton se është drejtuar jo kundër subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj, por kundër gjyqtarit që ka shqyrtuar ankimin për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Pretendimi i ankuesit për sjelljen e gjyqtarit në seancë gjyqësore nuk është kompetencë shqyrtimi nga ana e prokurorit, i cili është palë në proces, por është kompetencë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Seancat gjyqësore të dokumentuara me sistem regjistrimi mund t'i aksesojë ILD-ja. Ndërsa, për sa i përket sjelljes sime në çdo seancë ajo ka qenë etike.*

*Për kallëzimin e datës 7.2.2020 të bërë në Komisarariatit të Policisë Skrapar nga shtetasit B. M., K. M. dhe Q. M. kundër shtetasit E. S., sqarohet se me vendimin e datës 14.2.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. *** viti 2020.*

*Në datën 26.5.2021 jam transferuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe nuk është më përgjegjësi imja ndjekja e këtij materiali, por ju bëj me dije se nga shkresa nr. *** prot., datë 18.1.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, rezulton*

se vendimmarrja ime është ende në fuqi, sepse materiali kallëzues vazhdon me status mosfillim procedimi penal”.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni çmoi se pretendimet e denoncuesit në adresë të subjektit të rivlerësimit nuk qëndronin, duke qenë se ato ishin të pabazuara dhe të pambështetura ligjërisht.

22.6 Denoncim nr. * prot., datë 2.2.2018, i shtetasit S.B**

Ky shtetas i është drejtuar Komisionit me një letër dhe ankohet për problemin e tij se nuk po gjen zgjidhje nga Gjykata e Rrethit Beratit. Ai tregon se në vitin 2016 shtetasi I. Ç. ka shkaktuar aksident, duke i marrë jetën bashkëshortes së denoncuesit, i cili sipas tij po ecte me shpejtësi të lartë. Sipas shtetasit S. B, *kriminelin e nxori nga burgu lëvizja mafioze Prokurori-Gjykatë-OPGJ dhe “oktapodi” i Prokurorisë së Përgjithshme E. K., i cili ndihmon me ekspertizat manipulatore ata që ka miq.* Denoncuesi përmend shumë emra, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit G. Habazaj, për të cilin thotë se *të gjithë së bashku, pas ekspertit famëkeq që nxori shpejtësinë e makinës me 39 km/orë, i dha pafajësi I.Ç. Ishte Gjykata e Apelit të Vlorës ajo që e riktheu në burg I.Ç., por oficeri i policisë gjyqësore e ndihmoi të fshihej për 5 muaj, derisa ai u dorëzua në polici sipas porosisë së miqve.* Sipas denoncuesit, janë bërë 25 seanca maratonë e gjyqi nuk ka përfunduar për vrasësin I. Ç. Në përfundim të denoncimit, shtetasi S. B kërkon mundësimin e një ekspertize tjetër.

Duket se prokurori i kësaj çështjeje ka marrë për bazë aktekspertimin autoteknik, me qëllim vlerësimin e shkallës së fajësisë të drejtuesit të automjetit në drejtim të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen e një personi, në lidhje me ngjarjen e ndodhur.

Por, për një vlerësim të situatës, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, si dhe për ecurinë e kësaj çështjeje. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kundërshtoi pretendimet e shtetasit S.B, për shkak se ato nuk pasqyrojnë të vërtetën në lidhje me veprimet procedurale të prokurorit. Subjekti është shprehur se: *“Shtetasi S. B., përveçse nuk thotë të vërtetën, përdor epitete fyese dhe shkrim denigrues kundrejt meje. Nga ana ime si prokuror i çështjes është kërkuar që në momentin e arrestimit e deri në përfundim të hetimit masa e sigurimit “Arrest në burg” për të pandehurin I.Ç dhe, kur gjykata ka zëvendësuar këtë masë sigurimi me atë të “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, kam ushtruar ankim kundër vendimit gjyqësor dhe kam kërkuar për të pandehurin “Arrest në burg”. Në sajë të ankimit tim, Gjykata e Apelit i riktheu të pandehurit I.Ç masën e sigurimit “Arrest në burg”. Kam kryer riekspertim me grup ekspertësh, sepse akti i ekspertimit i kryer nga ing. E. K. ishte i paqartë. Kam pritur në takime shtetasin S. B. dhe familjarët e tij sa herë që e kanë kërkuar. Kam dërguar çështjen për gjykim në ngarkim të të pandehurit dhe ia kam njoftuar edhe shtetasit S. B. Kam qenë prezent në seancat e para gjyqësore dhe, më pas, për shkak të transferimit tim, çështja është përfaqësuar nga disa prokurorë të tjerë në gjykim. I pandehuri I. Ç. është deklaruar fajtor dhe ka vuajtur burgimin”.*

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti ishin të plota dhe bindëse, në vështrim të të gjitha detyrave e përgjegjësi të një prokurori.

22.7 Denoncim i përsëritur i shtetasit V.M nr. * prot., datë 22.7.2019, nr. *** prot., datë 22.7.2019, nr. *** prot., datë 22.7.2019, nr. *** prot., datë 9.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 9.7.2021**

Ky shtetas ka paraqitur denoncime pranë Komisionit nga viti 2019 deri në vitin 2021 për shumë subjekte rivlerësimi, si dhe ndaj prokurorit G. Habazaj. Nga dokumentacioni bashkëlidhur gjendet vendimi për mosfillimin e procedimit penal i datës 27.2.2019, të prokurorit G. Habazaj, i cili ka shqyrtuar kallëzimin penal të denoncuesit V. M, që ka kallëzuar noterin publik S. Sh., me pretendimin se ka shpërdoruar detyrën funksionale, sepse ka përpiluar një kontratë dhurimi

në kundërshtim me ligjet në fuqi. Palë në këtë kontratë janë motrat e tij, dhuruese të pjesëve takuese të pronës së tyre të përbashkët me kallëzuesin dhe shtetasi/pranuesi i dhurimit është K.M. Kallëzuesi ka pretenduar se prona nuk është dhuruar, por është shitur dhe kjo përbën një veprim fiktiv në thelb, si dhe se ai duhej njoftuar para se kontrata e dhurimit të përpilohej, kjo në respekt të së drejtës së parablerjes nga ana e tij, duke qenë se është bashkëpronar për të njëjtin objekt. Duket se prokurori i çështjes ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, në kuptimin e kryerjes së veprimeve hetimore verifikuese, si dhe pyetjes në cilësinë e deklaruesve dhe në fund ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të vitit 2019. Gjithashtu, nga dokumentacioni bashkëlidhur, duket se denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të tij. Sa më sipër, edhe në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni vlerësoi se nuk ka *indicie* që subjekti i rivlerësimit të mund të hetohej më tej.

22.8 Denoncim nr. * prot., datë 2.10.2018, i shtetasve N.K dhe S.V**

Këta shtetas kanë paraqitur denoncim për shkelje flagrante antiligjore, korruptive dhe kundërprocedurale të gjyqtarës Dh. B. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe të prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gentjan Habazaj. Referuar kallëzimit penal që denoncuesit kanë bërë ndaj gjyqtarës Dh. B., gjykata ka dalë me vendimin ***, datë 7.3.2014. Gjithashtu, kallëzuesit denoncojnë edhe veprimin e rëndë antiligjor dhe kundërprocedural të prokurorit G. Habazaj për vendimin e mosfillimit të hetimeve ndaj gjyqtarës së sipërcituar, i cili jo vetëm që nuk ka bërë hetim, por është bërë avokat i palës duke e pushuar atë.

Në denoncimin e tyre, N. K dhe S. V rendisin argumentet e tyre ndaj gjyqtarës në lidhje me konfliktin për pronën e tyre të bllokuar, por gjithashtu ankohen për faktin se prokurori e ka pushuar çështjen. Denoncuesit e mbyllin ankimin e tyre, duke deklaruar se: *“Këto shkelje procedurale të kësaj gjyqtareje na kanë futur në konflikt me familjen N. V. dhe K.”*. Duke marrë në konsideratë këtë ankim, konstatohet se çështja për të cilën ankuesit ankohen, ka të bëjë me mënyrën e trajtimit të konfliktit të tyre për pronën nga ana e gjyqtarës Dh. B., dhe pushimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit, sipas kallëzimit penal të bërë nga denoncuesit. Për sa i përket ankesave ndaj gjyqtarës Dh. B., ato nuk mund të jenë objekt i hetimit nga Komisioni. Ndërsa në lidhje me ankesat në adresë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk mund të hetonte më tej, për sa kohë kemi të bëjmë me një “gjykim” më tepër subjektiv nga ana e denoncuesve në lidhje me pushimin e kallëzimit të tyre ndaj gjyqtarës Dh. B. nga ana e prokurorit Gentjan Habazaj, sesa me paraqitje të fakteve e rrethanave konkrete në lidhje me një praktikë dyshuese, që të mund të krijohej bindja për shkelje ligjore konkrete nga ana e subjektit të rivlerësimit. Për më tepër që pretendimet për veprimtarinë e prokurorit që kanë lidhje me zbatimin/interpretimin dhe zgjidhjen e çështjes, kontrollohen nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit në gjykatë.

22.9 Denoncim nr. * prot., datë 2.5.2019, i shtetasit G.Sh**

Ky shtetas ka paraqitur pranë Komisionit një kopje të kallëzimit penal të tij ndaj prokurorit Gentjan Habazaj në lidhje me shtetasit A. dhe L. K, të cilët i kanë marrë hua vlera financiare të konsiderueshme kallëzuesit G.Sh, administrator i shoqërisë “K.” sh.p.k. Me kalimin e afatit dhe mospërbushjen e detyrimit për të kthyer këto vlera financiare, kallëzuesi/kreditori i është drejtuar Gjykatës e më pas zyrës së përbarimit për të mundësuar ekzekutimin e këtyre shumave nëpërmjet vënies së sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme të dy shtetasve huamarrës/debitorë. Në momentin kur përbaruesja ishte duke finalizuar procesin e sekuestrimit konservativ për shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga titulli ekzekutiv, ka rezultuar kontratë shitblerjeje mes shtetasit debitor L. K. me shtetasen H. Gj. Kjo kontratë shitblerjeje, sipas denoncuesit, është bërë me qëllim për të fshehur pasurinë e debitorit, që të bëhet i pamundur ekzekutimi i titullit ekzekutiv, si dhe kjo kontratë nuk është bërë në përputhje me ligjin për noterinë, pasi shuma prej xxx euro nuk është kaluar nëpërmjet bankës.

Referuar kësaj problematike, kallëzuesi i është drejtuar Drejtorisë së Policisë Vendore me një kallëzim penal për kryerje të veprimeve të kundërligjshme, që përbëjnë elemente të veprës penale të përmbaruesit, pasi kanë konsumuar elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Sipas kallëzuesit, prokurori G. Habazaj ka qenë në shpërdorim detyre, pasi në vendimin e mosfillimit të procedimit të datës 15.1.2018 ai nuk ka bërë asnjë lloj veprimi hetimor që të jepte mundësinë për të disponuar mbi natyrën e veprës dhe pasojave të saj, duke qenë se kallëzuesi nuk është marrë asnjëherë në pyetje nga prokuroria për të sqaruar mbi pretendimet tij. Kallëzuesi, referuar këtyre pretendimeve të mësipërme, ka kërkuar ndjekjen penale të subjektit Gentjan Habazaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit për trajtimin e kallëzimit penal për veprën penale të pretenduar “Shpërdorimi i detyrës”, kryer nga përmbaruesi privat, ka vendosur mosfillimin e procedimit, duke konkluduar mungesën e elementeve të kësaj vepre penale për veprimet e përmbaruesit privat.

Sa më sipër, për ecurinë e kësaj çështjeje, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion në lidhje me statusin aktual të çështjes. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kërkoi të vinte në dijeni Komisionin se nga shtetasi G.Sh është hequr dorë nga kjo ankesë. Në datën 31.7.2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, protokolluar me nr. ***, ka mbërritur me postë “Heqje dorë nga ankimi administrativ”, i bërë në Komision kundër prokurorit Gentjan Habazaj. Në heqjen dorë thuhet se do të ndiqet rruga gjyqësore për pretendimet e shtetasit G.Sh . *“Në datën 27.9.2019 më është ndërprerë komandimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe është vendosur rikthimi im në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Nga shkresa nr. *** prot., datë 16.1.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se vendimmarrja ime është ende në fuqi, sepse materiali kallëzues vazhdon me status mosfillim procedimi penal.*

*Pasi jam njohur me ankesën që shtetasi G.Sh më ka bërë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, jam vënë në dijeni se ky shtetas më ka bërë kallëzim penal për vendimmarrjen time. Me vendimin e datës 14.6.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. ***, viti 2019, të shtetasit G.Sh kundër Gentjan Habazaj. Shtetasi G.Sh është ankuar në gjykatë kundër vendimit të mosfillimit. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. ***, datë 16.9.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së G.Sh dhe lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit për kallëzimin nr. ***, viti 2019. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është lënë në fuqi me vendimin nr. *** akti, datë 26.12.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës”.*

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer shkelje procedurale apo moskryerje veprimesh hetimore në drejtim të ndjekjes së çështjes së ngritur nga denoncuesi G. Sh.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

23. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gentjan Habazaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentjan Habazaj, prokuror, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 31.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi